



Dukagjini

Botim Periodik i Shoqatës Atdhetare "Dukagjini", Viti i XII i botimit, nr. 125, mars 2014

Nr. Llog. UNIONBANK 510367047020112, Shkodër - Albania, Tel. 00355683191817, internet: www.shoqatadukagjini.com, Kryeredaktor: Lazër Kodra, Çmimi 30 lekë / 1.5 euro



DUKAGJININ PO E FSHIJNË NGA HARTA E SHQIPERISE, "SE KA RËNË PJELLORIA E GRAVE!" 3

A është Gjergj Kastrioti hero?

Nëse sot vjen Kina dhe na imponon bindjet e veta fetare si budizmin, shenizmin etj. e ne i bëjmë rezistencë, atëherë gabojmë shumë. Nëse ajo këmbëngulë herë me shpërblime, herë me gozhdime, herë me pozita – me pozita do të kenë më shumë efekte- dhe na motivon, detyron të konvertohem, atëherë në vitin 2412 gati të gjithë shqiptarët do të kenë përqafuar masovikisht kulturën kineze.

Në vitin 2514, njëqind e dy vite pas largimit të tyre, do shfaqet një shqiptar para një tempulli, që do të quhet Çen Cung Firi Fiu dhe thotë: "Shqiptarët që luftuan budizmin, shenizmin dhe konfucianizmin, kanë qenë tradhëtarë dhe duhet t' i përjashtojmë nga historia, sepse ata kanë prodhuar karmë të keqe në mes të tjerash. Ne sot jemi... dhe. Stërgjyshërit tanë qenë barbar... idiotë!" 5



Dita e mësuesit, në Komunën Rrethina

7 Marsi, është një event shumë i rëndësishëm për shkollën në përgjithësi e mësuesit në veçanti si festa e vetme e tyre. Ky i sivjetshmi përkoi edhe me jubileun e 70-vjetorit të çlirimit të atdheut, prandaj përpjekjet e kolektivave mësimore, të nxënësve dhe kontributi i komunitetit e pushtetit vendor ishin më të mëdha se sa vitet e tjera, për ta festuar sa më mirë. Duke shfrytëzuar orët e lira që shkolla ka në dispozicion, u zhvilluan veprimtari të larmishme 6



LAMTUMIRË Mhill LEKA, MËSUESI YNË I PARË

Këto ditë u nda nga jeta malësori i mirë dhe mësuesi i respektuar Mhill Leka. Nuk e kemi të lehtë ti shkruajmë këto fjalë, të cilat mbartin me vete dashurinë dhe respektim tonë dhe të gjithë atyre që e njohën, punuan dhe jetuan me të, që patën mundësinë e marrjes së arsimit dhe kulturës së mirë naci... të dhënë ngrohtësisht 7 Mhill Leka.

DIVORCI PO NA VRET...

«Më mungon diçka nga lumturia ime, më mungon lumturia e të tjerëve»,
Shën Agustini 10

Të dashur lexues çdo ditë e më shumë po dëgjojmë se si çiftet po divorcohen. Çdo ditë e më shumë familja, vatra e jetës, vatra e dashurisë po shkatërrohet.

Ju ftoj të ndalemi këtu, lë të mendojmë më shumë, ku po shkojmë me këto veprime tona, ne po largojmë veten nga dashuria e Zotit, me veprimet tona, thashethemet, krahmbajtjet, heshtjen, po e lejojmë këtë fenomen shkatërrues të jetës të rritet. Është për tu vajtuar kjo gjendje. Bashkëshortët po e humbin vetëdijen ndaj mëkatit, janë të pa përgjegjshëm në veprimet e tyre e kjo papërgjegjësi po shkakton atë që tani po jetojmë. Divorci përbën një problem madhor të ditëve të sotme. Rëndësia e këtij problemi rritet për shkak të përpjesëtimeve të mëdha që ka marr sot.

SIGMA 
VIENNA INSURANCE GROUP

Mundësoi Botimin:
NDUE FTONI





SHOQATA "ATDHETARE – DUKAGJINI"

Vendimi nr. 666, date 13 maj 2003

Lagja "VOJO KUSHI", rruga "ÇLIRIMI", pallati 1261, Shkodër, tel: 00355 22 43664, mob: 00355 692328116, adresa: www.shoqatadukagjini.com, e – mail: nduesanaj@yahoo.it

Nr. 1102 prot.

Shkodër, me 20 mars 2014

Lënda: KËRKESË, PËR KRIJIMIN E KOMUNËS DUKAGJINI, NË KUADRIN E REFORMËS TERRITORIALE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË

Drejtuar: Ministrit të Pushtetit Lokal, zotit Blendi Çuçi, TIRANË
Për dijëni: Presidentit të Republikës së Shqipërisë, zotit Bujar Nishani, TIRANË
Kryetari të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, zotit Ilir Meta, TIRANË
Kryetarit të Keshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, zotit Edi Rama, TIRANË
Kryetarit të Partise Demokratike, zotit Lulëzim Basha, TIRANË
Institucionit të Prefekturës, Prefektit, zotit Pavlin Rodovani, SHKODËR
Kryetarit të Keshillit të Qarkut, Zotit Maxhit Cungu, SHKODËR

ZOTI MINISTËR!

Më lejoni t'iu bej prezent një CV-i të shkurtër për Shoqatën "Atdhetare-Dukagjini", si më poshtë:

Shoqata "Atdhetare-Dukagjini" ka mbi 10 vjet që punon në qytetin Shkodër dhe rrethinat e tij, në Malësi të Madhe, në Lezhe, në Kurbin dhe në Tirane, në baze të misionit të saj: "Duke u mbështetur në historikun e së kaluarës dhe sotmes, duke respektuar ndjenjat dhe sakrificat e të parëve për liri e pavarësi, Dukagjini të zërë më mire vendin që meriton në botën e qytetëruar e moderne", ka bere përpjekje të punojë për t'ia arrite qëllimit.

Ajo, në këto dhjetë vjet ka një CV-i të pasur me shume veprimtari të ndryshme kulturore, artistike e shkencore, në veçanti:

1- Janë përgatite dhe zhvilluar gjashte simpoziume, një seminar shkencore dhe një Konferencë përkujtimore, në përgjithësi, me teme: "Dukagjini në rrjedhat e historisë":

2- Përgatite dhe nxjerre çdo muaj, duke filluar nga muaji Dhjetor 2003, gazetën e shoqatës, me emrin "Dukagjini", deri tani, gjithsej 124 numra.

3- Janë promovuar 55 libra të autoreve dukagjinas, që kane shkruar kryesisht dukagjinasi për Dukagjinin.

4- Bashkëpunim të ngushte me Shoqatën e Miqësisë Kosove-Malësi e Madhe "Martin Dreshaj", me qendër në Pejë, me datën 3-4 tetor 2009, në Shkodër, zhvilluam një veprimtari kulturore e artistike. Gjithashtu, jemi pjesëmarrës në Manifestimin "Zëri i Vëllazërimit- 2010, 2011, 2012 dhe 2013",

në Shkodër, në Prizren, Deçan, në Kline, në Glllogjan dhe në Istog.

5- Jemi anëtarë themelues të "Klubit të Medias Shqiptare", të grupit të veprimit lokal "Bjeshkët e Namuna" dhe të grupimit "Aleanca për Jetën"

Në jetën e saj, Shoqata ka vlerësuar shume figura dukagjinase për kontribute në shërbim të Dukagjinit, Shkodrës dhe në mbare nacionalitetin shqiptar. Sot, kemi dy personalitete të dekoruar me dekoratën e larte "Nderi i Kombit", piktorin Lin Delija dhe albanologun Martin Camaj.

ZOTI MINISTËR!

Shoqata "Atdhetare Dukagjini" po ndjek me vëmendje punën që po behet për reformën territoriale që do të bëhet në Shqipëri, të cilën e mbështesim me të gjitha mundësitë tona.

Aktualisht në territorin, që quhet Dukagjin janë pesë Komuna: Shala, Shoshi, Pulti, Shllaku dhe Temali. Këto Komuna janë të vendosur në këto territore prej shumë shekujsh, dhe vetëm kanë mbijetuar midis shumë vështirësish natyrore, territoriale, shoqërore-historike. Kanë kaluar jetën me besimin, doket dhe traditat e tyre të ruajtura me rreptësi. Janë lidhur me ato male nga të cilat siguronin me vështirësi jetesën.

Dukagjini ka qenë dhe është një zonë me të kaluar shumë të vështirë, por edhe me emër dhe histori mjaftë të hershme dhe të mirë, të qëndrueshme, ka ruajtur traditat, kulturën, historinë,

gjenezën, doket dhe zakonet në mënyrën më të mirë të mundur. Komuniteti dukagjinas ka jetuar në varfëri, por kryelartë, sepse nuk ka pranuar tua shtri dorën të tjerëve, të bëhet urë kalimi, të ndryshojnë traditën e formuar në shekuj, nuk është bërë "raja" e askujt.

Në këtë reforme territoriale, ju propozojmë: Të behet, **bashkimi i Komunës Shalë, Shosh, Pult, Shllak dhe Temal në një Komunë me emrin "Dukagjin"**. Kjo, që ju propozojmë, pavarësisht nga emri, nuk është e re. Kjo krahine, ka qene Prefekturë dhe N/prefekturë, ka qene dhe në nivel Rrethi, gjithnjë me qendër në Kodër Shën Gjergj. Madje kjo zone ka qene dhe Ipeshkvi, me emrin Ipeshkvi e Pultit menjëherë pas shekullit IV, por me dokumente daton në vitin 877 (shekullin IX), me qendër here në fshatin Khan, që sot është fshat i komunës së Pultit dhe here me qendër në Kodër Shën Gjergji Edhe sot quhet Arqipeshkvia "Shkodër-Pult"

Çdo bashkim tjetër, çdo aneksim me territore fqinjë, kushdo qofshin ato, është një eliminim i këtyre zonave, i elementeve krahinë-formues të tyre, i dokeve dhe zakoneve të trashëguara në shekuj.

Nëse duam, që të kenë zhvillim në këto zona, në se shteti mendon për zhvillimin e këtyre zonave, që aq shumë u përpoqën për të mbijetuar, për ti dhënë atdheut, vendit, krahinës atë që kishin dhe aq pak morën, ky propozim duhet të miratohet.

Bashkime të pa studiara, të pa menduara bëjnë të mundur

që të zbehet e kaluara dhe sotmja, prandaj duhet ti ruajmë me këmbëngulje.

Sigurisht duhet të ketë kriterë, për ri-përcaktimin e ndarjes territoriale, por jo të behet kusht i domosdoshëm numri i banorëve në komunat që mendohet se, duhet të ketë dhe kriterë të tjera. Edhe në Evrope, p.sh në Itali ka komuna periferike edhe me 500 deri ne 5 000 banore! Sepse, janë pare edhe rëndësia historike e tyre, rëndësia territoriale e tyre; ndërsa në këto 5 komuna janë të regjistruar mbi 6 000 banore. Nuk përjashtohet mundësia që nesër kjo krahine do të shfrytëzohet shume dhe pasi ka filluar me kohe. Vetëm në fshatin Theth, në periudhe Vere, vetëm të huaj vijnë mbi 2 000 vete në vit.

Mendojmë se, duhet tërhequr dhe mendimi i kryetareve të komunave, duhet tërhequr mendimi i shoqërisë civile, të intelektualëve të zonave përkatëse se, edhe këta janë të përgjegjshëm dhe e duan përparimin. Askush, më mire se këta nuk mund të sjelli fakte e argumente, që reforma territoriale duhet bere, madje dhe shume efikase, por të organizohet diskutimi me ta. Mendimi i tyre duhet kërkuar pasi kanë mundësi dhe duhet të bashkëbisedojnë dhe bashkëpunojnë midis tyre, të unifikojnë mendimet e tyre dhe të komunitetit që përfaqësojnë dhe ti publikojnë ato edhe përpara Qeverisë.

Problem me shumë rëndësi është edhe turizmi, i cili ka filluar shumë kohë përpara në Alpet Shqiptare dhe që po vjen duke u shtrirë në shpatet e luginat e

tyre, por këto vitet e fundit ka marrë një zhvillim më të shpejtë, është zgjeruar dhe pasuruar në llojshmëri. Është nga burimet kryesore të Dukagjinit për rritjen e të ardhurave, prandaj është domosdoshmëri për ti qëndruar sa më afër.

Dukagjini nuk ka nevojë që të jenë shtojcë e askujt, plotësues i askujt në organizimin administrativ vendor. Ai ka kulturën, historinë dhe doket e veta. Ka shikimin drejt së ardhmes me kulturën e tij të mirë, me ndryshimet që i kërkon përparimi. Nuk duhet kërkuar që të shpërndahet dhe të tretet në të tjerë kjo popullsi, që i ka rezistuar jetës me shekuj në këto territore, që ka jetuar midis shumë vështirësish duke ruajtur gjakun për të mos e përzier, duke ruajtur gjenezën dhe trashëgimin.

Për këto, dhe shumë të tjera, kërkujmë me këmbëngulje që emri "Dukagjin" duhet të rrojë zyrtarisht në emërtimin e Komunës që do të përfshijë këto territore. Është një emër shumë i vjetër, përmendet që në shekullin e VII, pastaj si familje princore, dinasti, principatë, sanxhak dhe ka ardhur në ditët tona i plotë.

Emri "Dukagjin" i bën nder Komunës që do ta mbajë dhe gjithë vendit.

Besojmë në mbështetjen tuaj që emri "Dukagjin" të rrojë edhe në të ardhmen!

**KRYETARI
NDUE SANAJ**

DUKAGJININ PO E FSHIJNË NGA HARTA E SHQIPERISE, "SE KA RËNË PJELLORIA E GRAVE!"



Nga
PRELË MILANI

Në historinë pa emër të shtetit shqiptarë, ky shtetit që kemi montuar në mënyrë mekanike këto 23 vitet e fundit ndonëse i veshur me një vello demokratike, nuk është gjë tjetër veç një krijesë laskare, pa prestigj e pistë, e degjeneruar, grabitqare, shkatëruese, deri në themel të gjithçkaje sa që nuk ka mbetur gjë në këmbë pa u çmatur, vjedhur, plaçkitur, djegur dhe shitur.

Nuk kemi më pyje, as shtretër lumenjsh, as diga, as argjinatura, as kanale ujitëse, as fabrika, as ferma, as miniera, madje kemi arritur deri aty sa kemi shitur për pese pare nëntokën, detin dhe qellin.

Dukagjini i gjendur në "mëshirën" e këtyre Zotave mashtrues të pushtetit të ri, nuk i mbeti tjetër rrugë, veç të merrete një arratisje biblike nga ato male ku krijoi dhe ruajti identitetin shekullor, drejt periferisë së zymtë të qyteteve tona të mjera, drejt fushave tashmë të kthyer moçalishte, ose zhare të thata, madje nuk e ndali turrin edhe drejt shteteve të botes së lirë. Kudo që shkuan dukagjinasi e shkretë punuan si diva, u dërsitën, u rropotitën, duke shkukur edhe qimet e kokës të blinin një truall, të ndërtonin një shtëpi, të bënin një dyqan apo të bënin një biznes. Dukagjinasi i gjendur në "mëshirën" e këtyre Zotave mashtrues, edhe shtyllën e elektrikut edhe gropën e kanalit e nevojtores edhe rrugicën e bal-

tosur të lagjes së re edhe kabullin e telefonit dhe internetit i beri me shpenzimet e veta. Dukagjinasi e rrethuan Shkodrën (Parajsën e ndaluar shumë shekulle) dhe viset ku u ngulit me ndërtime të reja për tu pasur zili dhe nuk është aspak mëkatarë për anarkinë urbanistike, pasi askush nuk i tha: Këtu ndërto, e këto mos ndërto, këtu duhet rruga, këtu trotuari, këtu duhen kanalet e zeza dhe këtu ujësjellësi. Dukagjinasi të gjendur në "mëshirën" e këtyre Zotave mashtrues gabuan në mënyrë të pa falshme, duke kthyer në tokë të zbrastë vendlindjen e vet, e cila ka kapacitete natyrore të mbante 40 përqind të popullsisë që ekzistonte në fillim të viteve 90-të. Shumica e tokave kullosave dhe pyjeve, me të cilat gjyshërit tanë siguroam mbijetesën e mundimshme, kanë mbetur shkret si mall pa zot të pa regjistruara as hipotekuara as kund. Madje unë, duhet thënë shqyrr Zotit që nuk ka pasur infrastrukturë rrugore normale se do të ishte bërë kërdua si në Cukal, Lurë, pyjet e Pukës, Librazhdit, Korçës e Mirditës. Nesër këto pyje, këto kullota të pa hipotekuara do të sulmohen nga piratet e ri që kushedi se nga do jenë dhe çfarë kostumi politik dhe ekonomik do kenë.

Realisht sot, në Dukagjin ka shumë pak banorë pasi nuk ka as një kusht për jetesë, as rrugë, as shkollë, as drita, as telefon, as shëndetësi, madje as zyra komune. Defakto, Kryetaret e Komunave të Dukagjinit jetojnë në migracion, në Shkodër dhe vulat i mbajnë "xhepave" dhe priten e popullit e bëjnë klubeve. Një poshtërim i tillë ndaj atyre banorëve me të vobektit që kanë mbetur atje, vetëm

kolonizatorët spanjoll dhe portugez ndaj indianëve te Amerikës mund të kenë bërë. Shteti ynë kopjac si majmuni një herë e ndau Shqipërinë në qindra Komuna, Bashki, Profektura e Qarqe, tani ka vendosur ti bashkojë të gjitha në shartesa hibride pa ditë gjë fare se çfarë do pjelli gomarica mushk apo kërric. Shteti Laskar shqiptarë e shtyri Dukagjinin një prej zonavave më të spikatura të maleve shqiptare drejt vetëvrasjes administrative sa çdo gjë ka marrë fund dhe tani po e groposë si kafshë të ngordhur duke ia bashkangjitur mekanikisht një zone tjetër dhe duke shuar përfundimisht si identitet, gjeografik, etnografik, historik dhe politik. Edhe qyteti të shenjtë të Jeruzalemit dhe Vatikanit, apo Stambollit sikur t'i bashkëngjitet Dukagjini im nuk e njoh nuk e pranoj as nuk do të votoj kurrë, "gubernatorët" e këtyre bashkësive hibride. Unë nuk do të votoj kurrë për as një ligjvënës të Kuvendit të Shqipërisë, nëse arrihet deri aty sa të fshihet nga harta administrative e shtetit shqiptar Dukagjini!!!

BËJE ZOT ENDERR

Nëse heshtim dhe pranojmë për të ngrënë këtë paçavure që po projektujnë të gatujnë ca kuzhinierë të pa zanat, varret tona nesër do të jenë të mbuluara nga turpi.

Ne, nuk po i kërkojmë shtetit shqiptar as të na shpallë Kryeqytet, as nuk po bëhemi separatistë, të vetë shpallemi as Principatë apo Republike. Ne, kërkojmë na leni emrin që kemi shkruar mbi ato male se, ato janë malet tona të një mijë kënduara

Ne, dikur kemi qenë Rreth (nënprefek-

turë) me vonë Lokalitet dhe së fundi 5 komuna të vogla, nuk po bëhemi pengesë për integrimin në Evropë po qe se, ky shtet na le administrativisht ashtu siç na ka falë Zoti, pasi shteti ynë ka 100 vjet që vetëm në mëshirë të fatit dhe shikës sonë të dorës na ka lanë.

Pse, duhet të mos ekzistojë më Dukagjini?! Janë ca motive cinike që servilen si shkaqe madhore reformuese sundimit të ligjit administrimit të territorit. Dukagjini duhet copëtuar se, nuk mund e lidhim me rrugë makine, as në shekullin e XXII pasi, për këtë shekull nuk ka as një perspektivë. Dukagjini duhet copëtuar dhe bashkangjitur dikujt tjetër mekanikisht, pasi gratë tona nuk kanë pjellori sa të krijojmë një njësi administrative sa parashikon projekti i ndarjes së re administrative, që defakto Dukagjinin po e fshijnë nga harta administrative e Shqipërisë. Dukagjini së paku 12 mijë banorë i ka të regjistruar edhe sot.

Amanet ju, që jetoni në Itali, Zvicër, Austri dhe shtete të tjera në Evropë, a dini me na thënë se, a ka andej nga ju komuna edhe me kaq banorë?! Nëse kërkohet të behet një eksperiment shabllon pa ditur se kurrfarë pozitiviteti do ketë, atëherë duhet reaguat fort dhe me kuraja, pa dallime politike, deri në referendum lokal po qe nevoja. Habitem jashtëzakonisht, habitem me përgjumjen, indiferencën, madje dhe moskokëçarjen e shumë intelektualëve dukagjinasi, të cilët si në shumë raste te vetë-përfaqësimit këto 16 vjet kanë thënë si gomari: "Beje Zot ëndërr!"

Çfarë duhet të dimë për infarktën e zemrës nën dritën e zbulimeve më të reja

* **Infarkti i zemrës (Infarkti i myocardit) – IM është i lidhur me bllokimin nga një pirq (koagul) gjaku i arteries që ushqen zemrën (arteret koronare) dhe krijon një dëmtim në indin e zemrës (nekroza izhemike e myocardit).**

* **Trajtimi konsiston ne hapjen sa me të shpejtë që të jetë e mundur të arteries së prekur deri në rivendosjen e qarkullimit të rregullt dhe të kufizohet shtrirja e prekjës së zemrës.**

* **Objektivi i kërkimeve mjekësore është që të shpëtohet i prekuri nga infarkti (pra të mbijetohet), të evitohen recidivat (përsëritjet) dhe të ulen rreziqet tek personat e ekspozuar dhe të gjinden trajtime më të reja gjithnjë e më efektive.**

Infarkti i zemrës me shifra

Rreth 120.000 raste të reja raportohen ne Francë çdo vit. Ndërkohë që vdekshmëria (mortaliteti) brenda 30 ditëve të para të sëmundjes ka rënë në

mënyrë spektakolare që këtu e 15 vjet (nga afro 70% që ishte në 10% të rasteve), pacientët vdesin në orët e afërta pas kalimit të infarktës, pa arritur akoma në spital (sidomos rastet e neglizhuara e te vonuara) dhe 15% vdesin gjatë vitit të parë. Popullsia që përmban patologji në evoluimin, popullsia nën 60 vjeç po shton numrat e infarkteve. Duhet shënuar se edhe gratë e reja janë më të prekura: në 2010, 25% e nën 60 vjeçarëve kishin kaluar tashme infarkt, në kohën që në 1995 – Kjo moshë përbënte vetëm 10%. Infarkti i myocardit po behet me vdekjeprurës se sa kanceri i gjirit.

Cilat janë shkaqet?

Pirja e duhanit kryesisht tek gratë. Atheroskleroza shkak kryesor i infarktës të zemrës. Infarkti është vdekja e një pjese te muskulit te zemrës (miokardit). Kjo prodhohet kur një arterie koronare, që ushqen zemrën me gjak bllokohet.

Zona korresponduese e zemrës në mënyrë te menjëhershme privohet nga ardhja e gjakut dhe prurja e oksigjenit

duke vuajtur dhe dëmtuar në mënyrë te pandreqshme.

Shkaku kryesor i infarktës është atheroskleroza që fillon me formimin e pllakës së atheromes e ndërtohet nga kolesteroli, fibrina dhe mbetje qelizore, mbi paretin brendshëm të arteries. Këto pllaka krijojnë një inflamacion kronik në nivelin e murit te arteries e cila si artere bëhet e thyeshme (fragjile). Pllaka mund të çahet (rukturohet) provokon krijimin e një trombi (pirq gjaku) qoftë në vend ose në distancë (pa të shkëputet) duke bllokua arterien.

Ja dhe disa nga faktorët e rrezikut.

Duhan pirja, niveli lartë i kolesterolit total dhe LDL – kolesterolit (Kolesteroli i keq). Tensioni i lartë (HTA), pirja e tepërt (keq përdorim) e alkoolit, mbipesha, mënyra e jetës pa lëvizje (sedentarizmi).

Cilat janë simptomat?

Është kryesore që të kapim sa më herët shenjat paralajmëruese të një personi mbartës.

Dhimbja prapa dërrasës së kraharorit

(retrosterenale) në rajonin e zemrës, në qafë, në nofull, në shpine etj. që përhapet drejt krahut, prapa në shpatull, ose në raste atipike drejt stomakut, dhimbje e cila është e fortë dhe nuk qetësohet me analgetikët e zakonshëm.

Nganjëherë kjo dhimbje shoqërohet dhe me shenja te tjera si ankth, frikë nga vdekja (një katastrofë e vërtetë), zënie frymë, tendencë për vjellje, zbehje, djersë të ftohta. Shenjat e infarktës ndryshojnë shumë nga një pacient tek tjetri dhe mund të mos ketë dhimbje sidomos tek diabetikët, të moshuarit dhe gratë (që gjithmonë e neglizhojnë).

Cili është trajtimi?

Menjëherë sapo të dyshohet për infarkt duhet të jepet Trinitrine nën gjuhë (0,3 – 0,5 mg) ¼ aspirinë (acid acedo salicilik) nga goja etj. Të njoftohet urgjenca për t'a drejtuar në urgjencën e specializuar të njësive koronare. Objektivi i mjekëve është që të zhblokohet (të hapet) arteria e taposur (bllokuar) dhe të rivendoset sa më shpejt qarkullimi për ushqyerjen e sektorit të zemrës. Në se kjo bëhet brenda 120 minutave të para nga fillimi i dhimbjes është me dobi, por prognoza (ardhmëria) varet dhe nga shtrirja e zonës së prekur.

(vijon në faqen 4)

PATRIOT E ATDHETAR NË TRE BREZA

- ME BESE, BUJARI E TRIMËRI KOLE MARK KOLA -

Përfaqësuesi i sundimtarit, të Begolajve në Peje, në ato vite vjen në Shale, me një ushtri të "madhe", mblodhi parinë dhe dha urdhër të ndërtohen disa xhami, duke filluar nga fshati i Abatit dhe banorët të kalojnë në besimin islam.


Kole Mark Kola, jo vetëm e kundërshton hapur, por vendosi ta vras, dhe e vret. Begolli ndërron jete dhe ushtria kthehet nga kish ardhur. Për rrjedhoje, jo vetëm që xhamitë nuk u ndërtuan, jo vetëm në fshatin Abat nuk u ndërtua xhami, por që nga ajo dite as në gjithë krahinën e Dukagjinit, duke mbetur me fenë e Krishtit. Për këtë akt patriotik të Kole Mark Kolës, populli ka këndua e duhet të këndojë: "N'Lotaj të Shalës n' ato troje / në ato bjeshke me mriza e kroje / lum ajo dere që e rriti nana / Kole Mark Kolen trim si zana / Në dere të kishës ka ba bene / sa t' bajne drite dielli mbi dhe / pa u përmbys malet e mia / kurrë në Shale s' behet xhamia ..."

Djali i Kole Mark Koles, Miter Kola, luftëtar i veçante ndaj pushtuesit. Ai ndërtoi një top, siç thotë populli prej dardhe (në fakt nuk është bere top prej dardhe, por duke shfrytëzuar një gryke zjarri mortaje, i ndërton mbështesin prej dru dardhe), dhe del në Qafe të Agrit së bashku me luftëtar të Shalës dhe të Dukagjinit, për të thyer forcat ushtarake të Turgud Pashës, duke bere jehone në këtë përpjekje të forcave. Topin e lidh me një picak ahut e duke e mbush me barut, sa që nga frika e çudia armiku tërhiqet, për të cilën populli thuri këto vargje: "Miter Kola në kapuç t'bardhe / n'tiraj, shoge e xhamadan / e punon topin dru dardhe / Dergud Pashës i thirret budalle / t'i n'keto male ik sa më pare / se male e shkrepja i kem kthye në arme ..."

Djali i Mitër Kolës, Kole Mitri, në moshën 22 vjeçare vritet, në luftën me malazeze, në muajin korrik 1915, në Nennavriq për mbrojtjen e lirisë, i shpallur dëshmorë i atdheut.

Kole Mark Mitri, babai i Zef Kolës, lindi e u rrit jetim, me aq vuajtje jetese, me 7 fëmijë dhe me besnikëri e bujari në

Kodër Shën Gjergj, dikur qendra e rrethit të Dukagjinit, duke punuar si punëtor me shume përkushim në pune të ndryshme, për të rritur fëmijët ... Në këto kushte, ai ka jetuar edhe ngjarje të dhimbshme, duke qenë prezent, dëshmitar të pushtimit nga forca të sigurimit të shtetit të asaj kohe, i cili i ka varros në afërsi të shtëpisë së tij. Dhe, për këtë akt humanitar, të afërmit e tyre ruajnë aq respekt në jete ... Kola ka punuar e drejtuar edhe në fshatin e tij, me detyra shoqërore dhe në pushtet, në të cilat ka punuar me



perkushtim, për të cilën e gjithë krahina e Shalës e kujtojnë me respekt fisnikërinë, guximin e bujarinë e tij.

Djali i tij, Zef Kola jeton me nder familjarisht e krenar për historinë e patriotizmin e të pareve të tij, i cili si pasardhës veteran e justifikon plotësisht titullin e nderuar në shoqate, në shoqëri e në krahinë. Ai, ka ruajtur me korrektësi amanetet e të pareve të tij. Është dalluar në detyrën shoqërore e shtetërore në zone, në detyrën e përgjegjësit të rinisë të sektorit, kryetar i pushtetit në fshat, gjyqtar, mbi 20 vjet punonjës i dalluar në sektorin e tregtisë dhe përgjegjës bllokut në zonën e Shoshit. Gjate jetës e veprimtarisë së tij është karakterizuar nga burrëria, bujaria,

ndershmëria, familjare i mire e vazhdues i denje i t' pareve të tij, me fëmijët e tij të nderuar, me 4 djem e 4 vajza, një prej të cilëve në shkollë për meshtar.

Ja siç shkruan autori i librit, Marash Kola: "Dashuria e madhe për Dukagjinitin", "I nderuar Zef, të dhuroj këtë libër në shenjë respekti e mirënjohje për paraardhësit tuaj, për kontributin e madh që ata dhanë në dobi të krahinës e te shqiptarise". Në këtë libër, ai shkruan: "... Kole Mark Kola, gardiani i Krishtit (siç është vlerësuar ai për s' pari për mbrojtjen e fesë së Krishtit në krahinën tone e më gjere), dhe Mitër Kola, i biri i tij, sajoj topin e dardhës, me të cilin drejtoi e qëlloi, në mënyrën më të mundshme pushtuesin Osman, në Qafe Agrit, 1910"

Po siç shkruan Prele Milani e Lazer Kodra, në librin historik "Dukagjini ynë": "Nëse ka ndonjë vend (dhe ka shume),

due me deke / ...". E që, nga ajo kohe nuk është tentuar synim islamik me dhune në zonat veriore shqiptare. E pra, shkruajnë autoret: "Në panteonin e burrave atdhetare të Dukagjinit askush nuk mundet të qëndroj përpara Kole Mark Kolës, si krye trim, martir për fenë e Krishtit".

Është për t'u habit dhe ndjejë keqardhje, kur në programet folklorike të viteve të fundit nuk pasqyrohen e interpretohen këngët e Kole e Mitër Kolës, të kënduar në vite nga ansambli i shtëpisë së kulturës "Shkurte Vata", në Shale. Është imitua topi në skene i drejtuar nga Kole Drethi, nga fshati Nicaj, shoqëruar nga grupi dhe orkestra, duke u paraqit në konkurrime në Reç e në Gjirokastrë. Ashtu sikur mungojnë mjaft pjesë folklorike, si: lahuta e Marash Ndout, gjethja e Vate Bashes, zumarja e Pal Çunit, fyelli i Gjelosh Vates, kënga e Gjergj Mar-



Zef Kolë Mitri

kut të Shoshit për Mitër Kolën; kënga e gjate, vallja e unazave dhe ne mënyrë të veçante "vallja e t' Lekeve" që pat tunde skenën e Gjirokastrës e të tjera e të tjera.

A nuk duhet të mendoje Shoqata "Atdhetare-Dukagjini" dhe pushtetit lokal për të nderuar këta figura e këtë familje, familjen e Kole Mark Kolës, për kontributin e dhenë në shërbim të lirisë e pavarësisë së krahinës e vendit?!

Përgatiti GJERGJ ÇUNI

(vijon nga faqe 3)

Në 70% të rasteve një angioplastikë (hapje dhe vendosje stenti) është e realizueshme ku një kateter me një mikrobalon që fryhet ndihmon në hapjen e enës dhe vendosjen eventuale të një unaze rrethore për ta mbajtur të hapur vazen (enën e gjakut). Po ashtu përdoren dhe ilaçe që mbrojnë nga formimi i mpiksjes së gjakut (trombit) ose ndikojnë në shkrirjen e tij si Klopidoqrel (plavix) 75mg në ditë ose Aspirinë 100mg në ditë si dhe statina për uljen e kolesterolit krahas masave të tjera higjeno-dietetike për një profilaksi sekondare kundër recidives (rikthimit). Kërkime shumë intensive në luftë kundër infarktit po përqendrohen për të përmirësuar depistimin (zbulimin) dhe marrjen nën kujdes për të kufizuar



rrjedhojat. Pra duhet të parandalohet kriza. Sot njihet roli i inflamacionit në zhvillimin dhe çarjen e pllakës së ateromës, pra kërkohet që me anë të ekzaminimeve të përcaktohet ateroma; po kërkohen biomarkerët e inflamacionit dhe po përmirësohet teknika e imazherisë mjekësore. Po ashtu po bëhen kërkime për rrugë të reja kuruese kundër inflama-

cionit lokal në pllakën e ateromës duke gjetur statina me efektive për të ulur kolesterolin si dhe antiagregant që të pengojnë formimin e saj. Gjenetika po ashtu po hap një pistë të re premuese për të ulur rrezikun e disa pacientëve. Mutacioni i genit PCSK-9

lejon që ne personat mbartës të tij të ulen në nivel minimal kolesterolin dhe të mos vuajnë nga atheroskleroza as nga infarkti. Shkencëtarët po kontrollojnë funksionin e këtij gjeni tek pacientët me rrezik të lartë për sëmundje cardio-vasculare.

Ka avancime shumë intensive me efekt të madh në marrjen nën kujdes të kësaj patologjie ku së fundi kërkimet kanë zbu-

luar se Ciklosporina po pengon hedhjen e transplantit (në trapiantet e zembrës) ose ajo ka aftësi të bllokujë disa mekanizma të vdekjes qelizore në kohën e infarktit. Ajo do mund të kufizojë kësajsoj prejkjen e muskullit të zembrës. Kjo provë klinike nga fondi i kërkimeve mjekësore (FKM) është në vijim për të vendosur impaktin mbi prognozën dhe cilësinë e jetës së këtyre të sëmurëve. Rezultatet priten të merren së afërmi. Së fundi po ashtu mjekësia regjenerative po vlerëson qelizat Staminalle (burimore) për të ndërhyrë në riparimin e indit kardiak të prekur në mënyra in vivo.

Përgatiti,
mjeku **NDUE K. NIKAJ**

A është Gjergj Kastrioti hero?

Nëse sot vjen Kina dhe na imponon bindjet e veta fetare si budizmin, shenizmin etj. e ne i bëjmë rezistencë, atëherë gabojmë shumë. Nëse ajo këmbëngulë herë me shpërblime, herë me gozhdime, herë me pozita – me pozita do të kenë më shumë efekte- dhe na motivon, detyron të konvertohem, atëherë në vitin 2412 gati të gjithë shqiptarët do të kenë përqafuar masovikisht kulturën kineze.

Në vitin 2514, njëqind e dy vite pas largimit të tyre, do shfaqet një shqiptar para një tempulli, që do të quhet Çen Cung Firi Fiu dhe thotë: "Shqiptarët që luftuan budizmin, shenizmin dhe konfucianizmin, kanë qenë tradhëtarë dhe duhet t' i përjashtojmë nga historia, sepse ata kanë prodhuar karmë të keqe në mes të tjerash. Ne sot jemi ndryshe. Stërgjyshërit tanë qenë barbarë dhe idiotë!"

Historia dëshmon se religjionet kanë afat skadimi. Në lashtësi askush nuk kishte besuar se politeizmi do të zëvendësohej nga monoteizmi, por ja ku e kemi, ndonëse i dëbuar nga shteti dhe me reduktim të shumë kompetencave, akoma përpiqet të jetë kryefjala e botës dhe shkencës.

Në fillim religjioni shpjegonte të gjitha fenomenet në natyrë dhe shoqëri, sot ka braktisur shumë fusha dhe me yjet nuk merret më ai, por astronomia. Me shërime dhe ekzorciçim nuk merret kleri, por spitali dhe psikiatria. Njeriu nuk vdes pse vendosi Zoti, por se kishte tymosur shumë dhe e katapultoi tejprtej kanceri. Të gjitha fatet njerzore, që dikur i atribuoheshin Zotit, sot për to akuzohet njeriu. Njeriu vdes në komunikacion jo pse Zoti kishte dashur, por sepse kishte ngarë makinën 200 km në orë. Makina mund të rrëshqas me 200 km në orë edhe nëse është e mbushur me enguj. Në vende ku ka pak makina, njerzit nuk vdesin aq shumë rrugëve, rrëzohen nga gomari apo kali, thyejnë një dorë apo këmbë apo fare dhe vazhdojnë jetën. Në Gjermani në vitin 1980 kanë vdekur në komunikacion 15.719 veta. Në vitin e kaluar 3340. Kontrollimi i shpeshtë, kufizimi i shpejtësisë, rripi, autostradat, kanë ndikuar në rënie të fatkeqësive dhe natyrisht edhe modelet më të mira të makinave. Në vendet ku mjekësia është e zhvilluar, njerzit jetojnë më gjatë pa marrë parasysh a besojnë në religjon apo jo, se sa popujt e varfër, që i besojnë monoteizmit apo politeizmit.

T' i kthehem temës. A është

Skenderbeu hero kombëtar? Nëse themi se nuk duhet të jetë sepse paska masakruar musliman, atëherë kjo është e barbartë me një ftesë një pushtuesi me bindje fetare muslimane. Nuk duhet ta mbrojmë lirinë tonë dhe pavarësinë shqiptare, por duhet t' i nënshtrohemi menjëherë. Nëse nesër na sulmon Afganistani apo Arabia Saudite, ne atëherë duhet të vrapojmë me lule para tyre. Ky qëndrim do të ndikonte edhe tek fqinjët tanë për të na parë dhe cilësuar si kolaboracionist potencial, që mezi presin ças-



tin për t' i shtypur edhe ata. Në paqe do të izolohemi, në kohë lufte, do të na copëtojnë.

Disa që kundërshtojnë Skënderbeun si hero kombëtar, kanë motivuar dhe manipuluar të rinjtë shqiptarë për të shkuar në Siri dhe luftuar kundër muslimanëve. Atje nuk por vriten muslimanët në mes vete, pse nuk janë musliman të mirë, por po vriten për bindje politike dhe madje shpresojnë të aterojnë në parajsë pse ka vuar shumë muslimanë. Muslimanët u vranë nga muslimanët në Egjipt, në Libi dhe tani edhe në Siri po vriten. Është tragjike, por kështu ka ndodhur edhe në vendet krishtere, kur me bindje fetare shkojnë njerëzit në luftë, kur një grup është i bindur se tjetri e ka gabim.

Disa po e quajnë Skenderbeun edhe serb, duke u përpjekur për të shfrytëzuar ndjeshmërinë dhe disponimin e sotshëm, për ta hequr qafe Skenderbeun një herë e përgjithmonë. Po të kishte qenë Skënderbeu serb, nuk do të vinte në Shqipëri, por do të shkonte në Serbi dhe çlironte atë. Përmendorja e Sk-

enderbeut, e Nënë Terezës flasin për qytetërimin shqiptar, sepse vendet perëndimore nuk gjykojnë personalitetet e veta nga bindja private fetare, por vlerësohen për imazhin e krijuar ndaj atdheut. Në anën tjetër, kleri musliman dhe katolik, nuk mund t' u referohen përqindjeve në popull, por vetëm atyre njerëzve që kanë para vete në faltoret e tyre. Në emër të popullit mund të flasë vetëm Qeveria e votuar.

Po pse Ferid Murad nuk përmendet si Skenderbeu dhe Nënë Tereza. Edhe ky ka merita

hebrej dhe një martua me një burrë katolike.)

Në vendet perëndimore mund edhe të ndërtohet një përmendore e Ferid Muradit, por tek ne vështirë të merret me mend, sepse edhe gratë do të kërkonin shpjegime. Fundi i fundit, ai nuk është hero i të gjithëve, por i atyre në gazep. Në demokraci ka të drejtë çdo njeri të madhërojë religjionin e vet, por kurrë të shajë të tjetrit. Demokracia nuk merret me bindjet e njerëzve, as fetare, as ateiste. Në demokraci ka vend për gjithë ata që dëshirojnë jetën në paqe.

Afganistan talebanët rrëzuan përmendoret e Budës edhe pse ishin në listën e UNESCO, si pasuri kulturore botërore. Tek ne rekomandohen personalitete historike vetëm duke u bazuar në bindjet fetare.

Duke u bazuar në bindje fetare, otodoksët quhen serb, duke u bazuar në bindje fetare, katolikët quhen kroat, duke u bazuar në bindje fetare, boshnjakët quhen musliman. Nëse shqiptarët durojnë ndarjen, grimcimin, ronitjen, në bindje fetare, atëherë nuk do të kemi një komb, por së paku tre. Ja pse feja e shqiptarit është shqiptaria dhe duhet recituar çdo ditë, para se të stigmatizojmë njëri tjetrin për religjionin e gabuar apo mungesën e tij.

Sikur zoti të ishte religjioz, do ta kishte dërguar vetëm një fe dhe vetëm një profet e jo ta korigjojë vetveten. Sikur në vendet perëndimore të pytej kleri, nuk do të kishin lejuar ndërtimin as të sinagogës, as të as xhamisë, as të tempujve budist. Se Perëndimi toleron ndërtimin e tyre, flet për qytetërimin e saj. Se populli shqiptar duron përmendore duke shpërfillur bindjet fetare, flet për qytetërimin e lartë shqiptar. Ata me sharjet e tyre, më shumë po largojnë njerëz nga feja, se sa që po afrojnë.

Nëse i ndërtojmë Dalai Lamës një përmendore, akush nuk do të na qortonte, por do të na çmonte si njerëz me një qytetërim të lartë. Nëse Italia do të gjykonte në këtë mënyrë, atëherë do të rrëzonte të gjitha përmendoret e perandorëve romak deri në shekullin katër. Ata që sot turpërohen me stërgjyshërit e tyre, nesër do ta rrëzojnë edhe Rugovën edhe përmendoren e Bill Clinton, sepse edhe ky i fundit, derisa qeveriste, ka urdhëruar vrasje në Irak apo Afganistan.

Sikur të isha serb nacionalist, do t' isha kënaqur me gjendjen e Kosovës, por meqenëse jam shqiptar, ndjehem shumë i zhgënjyer me mënyrën si ndërtohet shteti dhe si perceptohet demokracia. Me historinë shqiptare duhet të merren historianët: jo hoxhallarët, priftërinjt, dërvishët dhe shamanët. Këta nuk nuk punojnë për përparimin dhe bashkëpunimin e popujve, por për ndarjen e tyre. Sepse, sipas Schopenhauer, "Religjionet janë sikur xixëllonjat: për të shndritur, kanë nevojë për errësi."

Naser Aliu,
Gazeta "DITA",
10 Mars 2014

Dita e mësuesit, në Komunën Rrethina

7 Marsi, është një event shumë i rëndësishëm për shkollën në përgjithësi e mësuesit në veçanti si festa e vetme e tyre. Ky i sivjetshmi përkoi edhe me jubileun e 70-vjetorit të çlirimit të atdheut, prandaj përpjekjet e kolektivave mësimore, të nxënësve dhe kontributi i komunitetit e pushtetit vendor ishin më të mëdha se sa vitet e tjera, për ta festuar sa më mirë. Duke shfrytëzuar orët e lira që shkolla ka në dispozicion, u zhvilluan veprimtari të larmishme artistike dhe fizikurore-sportive si: fjala artistike, montazhe muziko-letrare, kampionate ndërmjet klasave e të tjerë, ku në këtë drejtim u dalluan shkollat Hot i Ri, Dobraq e Bardhaj. Festimet e 7 Marsit kulmuan me një drekë shumë cilësore, që komuna Rrethina shtroi për të gjitha kolektivat e komunës në lokalit të ri "Blue sky" me pronar, Gëzim Brahusa duke servirur meny të pëlqyeshme dhe muzikë që i përshtatej pjesëmarrësve, ku pati të ftuar edhe shumë mësues-sot në pension dhe, për të nderuar e vlerësuar pjesëmarrësit mori pjesë edhe administrata e komunës me në krye, kryetarin e saj, Luan Harusha, zv/kryetarin Gjovalin Colaj e kryetarin e Këshillit Lulash Nika si edhe disa drejtues institucionesh të Prefekturës Shkodër.

Një respekt e vlerësim i tillë nuk u është bërë mësuesve të komunës Rrethina nga drejtuesit paraardhës në asnjë 7 Mars. Madje, para disa vitesh u a dhanë një sasi parash-kesh për të ulur barrën e shpenzimeve në këtë kuadër, por mbas disa muajsh ju a patën ndaluar në rrogë. Kjo veprimtari e përbashkët e të gjithë kolektivave pedagogjike u shfrytëzua nga drejtuesit e komunës për të vlerësuar më në fund punën e bërë ndër vite në këtë komunë, si te mësuesit ne pension e të palodhur, Prelë Grima, të cilit ju dha titullin: "Mirënjohje e komunës Rrethina", me motivacion: "Për kontributin e dhënë

nga ana juaj për edukimin e brezave të rinj gjatë viteve që keni punuar në zonën tonë, me përkushtim e ndërgjegje të lartë. Nxënësit dhe banorët e komunës tonë do ju kujtojnë me respekt e mirënjohje". Duhet përgëzuar vlerësimi, që i bëjnë, por vlerësimi për punën e tij duhet të marri shtrirje më të gjerë, sepse është kontributori më i madh në fushën e ar-

simit si: inspektor në Rreth e në Ministri, Pedagog në universitetin e Shkodrës, drejtues shkolle dhe mësues në shkolla të ndryshme duke qenë i pari, me arsim të lartë nga komuniteti dukagjinasi. Mendoj se, në kuadër të 7 Marsit, duhet vlerë-



suar dhe diferencuar edhe puna e disa mësuesve, që aktualisht punojnë, siç ka qenë traditë, dukë ju dhënë ndonjë stimul moral e pse jo edhe material. Kjo, do ti shërbente në radhë të parë punës në sektorin e arsimit. Duhet cekë fakti se, asnjëherë pushteti vendor në komunën Rrethina nuk ka qenë më i disponueshëm për të ndihmuar shkollat se, në legjislaturën e mbas 2011-ës, si në përmirësimin e infrastrukturës, pajisjen me orëdi e materiale konsumi, përmirësimin e mjediseve brenda dhe jashtë shkollës, sigurimin e sistemeve të ngrohjes e të tjera.

Në të gjitha shkollat e komunës Rrethina vëmë re mobilizim për realizimin e detyrave në procesin mësimor-edukativ për të kurorëzuar me sukses vitin shkollor 2013-2014. Kjo, duket që nga disiplina në punë, pamja e jashtme e mjedisit të shkollës, pjesa figurative pa u futur në problemet e përbajtjes, ku mund të veçojmë shkollat Shtoj i Ri, Guci, Bardhaj e sidomos Hoti i Ri, drejtor i së cilës është Gjovalin Kodra, i cili ka bërë ndryshime rrënjësore në këto drejtime deri edhe në instalimin e kamerave të sigurisë duke tërhequr disa kontributor në këtë drejtim.

Me qenë se kjo kronikë është për gazetën "Dukagjini", vlen të theksohet

se, asnjë arritje në shkollat e komunës në fjalë nuk mund të imagjinohet pa kontributin e mësuesve dukagjinasi, të cilët janë me dhjetëra në çdo shkollë të kësaj komune, ku më shumë e ku më pak, vihet re se aty ku ka drejtues apo mësues më

në ndonjë fshat një dukuri negative, që shumë nxënës që kanë braktisë shkollën ti fusin në kontingjentin për gjakmarrje duke i fryrë shumë shifrat edhe për përfitime monetare, duke prishë imazhin e komunitetit. I ka ardhur koha që struktu-



Ish-mësuesi Prel Grima duke iu dërrëzuar certifikata "Mirënjohje" nga Kryetari i Komunës Rrethina, Luan Harusha

rat e arsimit qendror e lokal, drejtoritë e shkollave dhe kolektivat e mësuesve mos të merren vetëm me anën sipërfaqësore të shkollës, por rëndësi primare t'ju japin problemeve të përbajtjes të procesit mësimor-edukativ duke shtuar kontrollin në përgatitjen për mësim e dhënies jetë kësaj përgatitje në orën e mësimin duke rritë kështu cilësinë e asimilimit të programit mësimor nga ana e nxënësve, dukë përmirësuar metodat e mësimdhënies që të jenë sa më bashkëkohore dhe duke eliminuar plotësisht analfabetizmin e heshtur që ekziston në shkolla. Vetëm kështu ju përgjigjemi kërkesave të kohës që shkolla ka.

Të metat dhe mangësitë e vërejtura të bëhen mësim për të rritur mobilizimin për eliminimin e tyre, kurse arrijtjet që janë dominante të shërbejnë si bazë e shëndoshë për suksese akoma më të mëdha në të ardhmen në mënyrë që shkolla ta kryejnë më së miri misionin që ajo ka.

PRELË SHYTANI

FJALA PËRSHËNDETËSE E SEKRETARIT TE SHOQATËS "ATDHETARE-DUKAGJINI", LUIGJ SHYTI, TË PJESËMARRËSVE NË EKSPozITËN "SHAN PICI-1938"

Të respektuar pjesëmarrës!

Ndjem i respektuar që, i ngarkuar nga kryesia e shoqatës "Atdhetare Dukagjini" të përshëndes në këtë veprimtari mjaftë të rëndësishme për Shkodrën, Dukagjinin dhe shumë më gjerë.

Në të 160 faqet e albumit "SHAN PICI" ka dashuri, respekt, art, kulturë dhe histori nga ato male dhe ata malësorë. Në këtë album pasqyrohet çiltërsia e atyre banorëve, e përzier me skamjen ekonomike e arsimore të cilat nuk ja venitën krenarinë, mikpritjen, besën dhe as vullnetin për tjetuar dhe, për tu zhvilluar

Shan Pici fiksoi në celuloid tiparet karakteristike të banorëve të këtyre anëve, peizazhin mahnitës, të pastër, të virgjër, të bukur, por të heshtura e që prisnin të zgjoheshin.

Fotot e bëra nga Shan Pici kanë brenda zemrën, dashurinë dhe vullnetin e tij, që në një farë mënyre ngjasojnë me vargjet e lira të

Migjenit.

Nga fotot e këtij albumi, afër 90% e tyre janë pamje nga Dukagjini, pastaj nga Trovoja, Puka, dhe dy nga Shkodra.

Fotografi i pasionuar, Shan Pici, u bë i njohur me fotot e natyrës së Alpeve Shqiptare në vitet '30 të shekullit të kaluar, me të cilat tregoi vlerat profesionale, artistike vetes, por edhe pasqyroj vlerat e papërsëritshme të vetë Alpeve Shqiptare dhe banorëve të tyre.

Ne, bijtë dhe pasardhësit e atyre banorëve që paraqiten aty, duhet dhe, i jemi mirënjohës të nderuarit Shan Pici dhe gjithë atyre që e nxitën dhe e mbështetën, ndër të cilët, në mos kryesori, ishte biri i Dukagjinit, poeti, themeluesi i tregimit modern shqiptar, romancieri, përkthyesi dhe publicisti, Ernest Koliqi, që pasqyrohet edhe në faqet e këtij albumi.

Ky album shoqërohet me parathënie, të zgjeruar dhe të zgjuar, të shkruara me shumë

dashuri nga Robert Elsie dhe Drejtori i Fototekës Luçjan Bedeni.

Ky album është një rrugëtim në historinë dhe bukuritë e maleve të Dukagjinit në vitet '30, i shërben të sotmes dhe bën thirrje për të ardhmen. Për nga paraqitja e fotografive, kujdesit dhe dashurisë që pasqyrojnë dhe shprehin këto fotografi, ky album mund të quhet: "SHAN PICI – DUKAGJIN 1938".

Në emër të shoqatës "Atdhetare Dukagjini" shprehë gjithë respektin dhe mirënjohjen tonë, për fotografimin e nderuarit Shan Pici, por edhe për Fototekën Marubi, stafin e saj dhe veçanërisht të drejtorit të saj, energjikut, të kudondodhurit dhe punëtorit të mirë, Luçjan Bedeni, për punën që po bëjnë në ruajtjen dhe publikimin e vlerave të tilla që i bëjnë nder gjithë kombit tonë, dhe që besoj se do të vazhdojnë edhe në të ardhmen.

Ju falënderoj për kohën që më kushtuat!

LAMTUMIRË MHILL LEKA, MËSUESI YNË I PARË

Këto ditë u nda nga jeta malësori i mirë dhe mësuesi i respektuar Mhill Leka.

Nuk e kemi të lehtë ti shkruajmë këto fjalë, të cilat mbartin me vete dashurinë dhe respektim tonë dhe të gjithë atyre që e njohën, punuan dhe jetuan me të, që patën mundësinë e marrjes së arsimit dhe kulturës së mirë nacionale të dhënë ngrohtësisht nga Mhill Leka.

Personalisht ndjejmë dhimbje për ndarjen nga jeta të mësues Mhillit, por edhe jemi krenar që kemi qenë nxënës të tij afër 60 vjet më parë. Ai ishte mësuesi ynë i parë dhe i shokëve dhe shoqeve tonë të klasës, kur ne uleshim për herë të parë në bankat e shkollës në Theth.

U largua nga në njeriu i mirë, një burri i nderuar, një mësuesi i përkushtuar, i cili përcolli shumë breza drejt dijes dhe kulturës, drejt dymëve të jetës, drejt të ardhmes së tyre dhe të vendit.

Mhill Leka ishte birë i një familje të nderuar, e cila diti të bashkëpunojë në të gjitha kohërat, fitoj respektin dhe mirënjohjen e të gjithë atyre që patën rastin të takohen me të. Kjo familje e vendosur në një territor ku ishte edhe qendra e nënprefekturës dhe qendra e rrethit të Dukagjinit, buzë rrugës ku shkonin njerëzit në çdo kohë të ditës dhe natës, ku shkolin mendimet dhe mundimet, gjenin

prirje dhe respekt të thjeshtë dhe të thellë, gjenin strehën, ngrohjen, bukën, pishën për të ndriçuar rrugën natën, gjetën ndeshje, pritjen dhe



përcjelljen bujare të familjes së Lekë Camës.

Mhill Leka zgjodhi frontin e edukimit për ti shërbyer më mirë shoqërisë, njerëzve, për të përgatitur të ardhmen e tyre, për më shumë zhvillim dhe më shumë kulturë.

Ky mësues i përkushtuar filloj punën

shumë i ri, në fillim të viteve '50 dhe në një territor mjaft larg nga vendbanimi i tij. Ai filloj detyrën e mësuesit në Nikç të Kelmendit, që edhe sot kujtohet me shumë respekt. Punoi me devotshmëri shumë të madhe për rreth 40 vjet në arsim. Ka fare pak vende, në qoftë se ka, ku nuk punoi mësues Mhilli në të gjithë territorin e Dukagjinit.

Mhill Leka nuk ishte thjeshtë një mësues, por edhe një edukator për nxënësit, por ishte edhe mësues i mësuesve, sidomos i atyre të rinjve. Jepte kudo shembullin personal, tregonte se si ai kishte zgjidhur vështirësitë që i dilnin, si bashkëpunonte me nxënësit, kolektivin e mësuesve, drejtorinë e shkollës, prindërit, por dhe me organet e qeverisjes vendore. Shpesh ishte përbërës i grupeve të kontrollit dhe të ndihmës nëpër shkolla që organizoheshin në atë kohë. Ai, së pari kishte qëllimin e ndihmës, tregonte fletoret e punimeve të nxënësve të tij, si shkruanin, zi zgjidhnin detyrat në matematikë, si duhej korigjuar detyrat e shtëpisë, si kompletoheshin nxënësit me mjete mësimore, si mund të shfrytëzoheshin mjetet rrethore për konkretizimin e mësimit, etj. Ne dhe shokët e shoqet tona jemi krenar që ishim nxënës të mësues Mhillit.

Mhill Leka u nda nga kjo jetë, por la prapa një familje me të gjitha tipa-

ret e mira që duhet të ketë një familje Dukagjinase, një familje Shqiptare. Familjarët, të afërmit, por edhe të gjithë ata me të cilët punoi e jetoi, po ndahen nga një shok, një mik, një koleg, një njeri i mirë, një burrë i zgjuar dhe i thjeshtë, por do të ruajnë gjatë, shumë gjatë, kujtimin, emrin dhe punën e Mhill Lekës. Ne, ish nxënësit e tij u ndamë nga mësuesi dhe edukatori ynë të cilin do të kujtojmë gjithmonë për punën e tij të palodhshme për edukimin tonë, për edukimin e brezit të ri.

Bashkëshortja, fëmijët, por edhe gjithë të afërmit, shokët dhe miqtë e Mhill Lekës janë dhe duhet të jenë krenarë për gjithë trashëgiminë që la ky burrë i nderuar.

Mësues Mhilli, do të kujtohesh me shumë respekt për shumë e shumë vite, sepse kush merret me edukimin e brezit të ri bëhet vetë i pavdekshëm, e kujtojnë brezat, e kujton e ardhmja.

Lamtumirë prindi, burri i nderuar, malësori i mirë, mësuesi i pasionuar Mhill Leka. Lamtumirë mësuesi ynë i parë, që do të kujtojmë gjithmonë.

I lehtë të qoftë dheu që do të mbajnë.

Qofsh mirë me Zotin.

Familjarët, të afërmit, shokët, nxënësit dhe miqtë e tu rrofshin dhe të kujtofshim.

**LUIGJ SHYTI
E GJERGJ ÇUNI**

MARASH HAJATI

**- 14 VITE KRYETAR
I BASHKIMIT TË
GAZETAREVE TË
SHQIPËRISË -**

Marsh Hajati erdhi në jetë në Shkodër, në vitin 1934 nga prindër të një familje të fisme të fisi të fisëm të Mërturit (Dukagjin pasi Mërturi vetëm administrativisht ka qenë Malësi e Gjakovës, nënvizimi im), ku ishin vendosur prindërit e tij, të shpërngulur nga fshati Salcë

Në Shkodër përfundoi arsimin 7-vjeçar e të mesëm. Nga viti 1952 e deri në vitin 1957, ndoqi studimet e larta në Universitetin e Petërburgut, në Fakultetin e Filologjisë, dega Gazetari, shok dhe i një plejade me Dritëro Agollin. Diplomohet publicist dhe filloi punë si redaktor në gazetën "Puna" e më pas, sekretar kolegji i saj dhe instruktor për shtypin. Nga viti 1974 deri në vitin 1988 ka qenë fillimisht drejtor i Televizionit e që nga fillimet

e viteve '80 Drejtor i Përgjithshëm i Radiotelevizionit. Në vitet 1988-'90, Kryeredaktor i gazetës më rëndësishme të kohës "Zëri i Popullit". Për afro 14 vjet ka qenë Kryetar i Bashkimit të Gazetarëve të Shqipërisë.

Marsh Hajati ka ushtruar me shumë devocion, profesionin e gazetarit, dhe ka qenë njohës i mirë i traditave të hapësirës mbarë shqiptare.

Krahas publicistikës, është marre me studime e krijimtari letrare. Ka shkruar skenarë dhe për dy dokumentarë u nderua me "Çmimin e Republikës". Gjithashtu, publikoi disa libra publicistikë, ndër ta edhe jetëshkrimorë.

Me skenarët e tij janë realizuar disa dokumentarë televizivë, si

"Tërmeti tundi malet, por jo zemrat tona" dhe "Fitimtarë mbi tërmetin, të cilët u nderuan me "Çmimin e Republikës".

Libri i parë i tij, me shkrime publicistike, ishte: "Bijtë e tokës sime"(1982).

Libra të tjerë të tij, janë:

· Në librin "Dera e pasme e shtypit" (1998) pasqyroi ngjarje të ndryshme nga puna afër 40-vjeçare në këtë sektor.

· Një vit më vonë publikoi librin,

"Shqipëria në kapërcimin e Shekullit", me analiza e komente, parë me syrin e një gazetari.

· Çanta me kontratë (Poezi)

· Tish Daija, i veçanti (monografi - 2005)

· Vite befasish (kujtime)
· Histori dhe Vizion Stefani & Co (monografi)

· Libri i fundit i tij është "Dritëro: Kohës i falemi për këtë ditar" (Kujtime).

Edhe gjatë viteve të moshës së tretë nuk iu nda shkrimeve dhe publicistikës. Ai, themeloi Gazetën "Nikaj Mërturi" dhe ushtroj edhe detyrën e Kryeredaktorit dhe u shqua si veprimtar i Shoqatës Atdhetare-Kulturore, po me këtë emër.

Marsh Hajati ishte një personalitet shumë i kompletuar larg çdo reminishencë që mundë të ushqejë ndokush, përvoja e tij në fushën e letrave dhe të gazetarisë është një shkollë më vete.

PRELË MILANI



PAULINI DHE ESTRADA NJË ÇIFT I LUMTUR

NJË GUR I ÇMUAR NË GJERDANIN E HUMËRIT SHKODRAN -

Nëqoftëse do të ekzistonte një galeri, jo me piktura e skulptura, por në mënyrë butaforike, ku figurat përfaqësojnë tipa dhe personazhe që shprehin karaktere të cilët duhet të pasqyrojnë jetën njerëzore me të mirat dhe të metat e saj, do të duhej një specialist. Ta dini mirë se ky specialist është Paulin Preka. Ky është brigadieri, karpentieri, biçiklisti, doktori, muratori, profesori, dashnori, Cuku e Luku, pasaniku e i munduari, fukaraja e deputeti, malësori e fusharaku, intelektual e i padisiplinuar e ç'farë mund t'i kishte shkuar mendja çdo skenarist e regjisor për t'ia besuar një rol atij. E përsëris edhe një herë ky është aktori Paulin Preka.

E gjen në skeçe, kuplete dhe parodi, me një diksion të pastër që i referohet të folmes tipike shkodrane, me një vesh muzikor të admirushëm, me një plastikë që në fillimet e tia ia favorizonte moshën, si dhe eksperiencën e fituar, duke u radhitur në plejadën e shquar të aktorëve humoristë shkodranë që e pranuan në gjirin e tyre si të barabartë.

Paulin Preka ka lindur në Shkodër më 2.02.1935 në një familje të varfër. Ai kishte edhe një vëlla më të madh dhe dy motra. Puna e lodhshme e të atit, një punëtor shumë i nderuar dhe përkujdesja e jashtëzakonshme e së ëmës, i rritën dhe i edukuan me dashurinë ndaj Zotit, ndaj mëhallës, ndaj vendlindjes, por edhe ndaj intergrimit të tyre në vlerat qytetare të Shkodrës dhe që ishin rruga ku Paulini hodhi hapat e parë, i prirur nga talenti i tij për të shkruar biografinë e tij artistike, e cila vite më vonë do ta radhiste në brezin e artë të aktorëve që krijuan një plejadë të papërsëritshme.

Paulin Preka!

Në moshën 8 vjeçare, fare i vogël, u bë pjesëmarrës në shoqërinë artistike të Kishës Katedrale të qytetit të Shkodrës, e cila aktivizoi fëmijë dhe të rinj, jo vetëm në aktivitetet fetare, por edhe në aktivitetet kulturore dhe edukative, ku tematikat i afronin këta fëmijë me kryeveprat e letërsisë botërore të interpretuara në skenat e vogla të qytetit të Shkodrës. Pikërisht në këtë kohë dhe në këtë moshë, daton edhe interpretimi i parë i Paulin Prekës, i cili në melodramën "Shtatë Xhuxhmaxhuxhat", interpretoi rolin e tij të parë "Knapsi". Melodrama u pëlqye së tepërmi nga publiku artëdashës shkodran dhe bashkë me bashkëmoshatarin Çesk Jubani u vlersuan me çmim të parë.

Ky djalë simpatik, i shkathët dhe i zgjuar, e mbi të gjitha i talentuar do të bënte që rreth viteve 1945-1946 në moshën 11 vjeçare, mësuesi Lec Sekuj ta sillte në skenë me dramën "Djemtë e Rrugës Pal" të shkrimtarit hungarez Ferenc Molnar e cila u interpretua nga nxënësit e shkollës "Pashko Vasa". Në këtë dramë Paulini interpretoi një ndër rolet kryesore.

Rreth viteve 1947-1948 hapet në Shkodër Shtëpia e Pionierit ku u formua krahas rrethëve të tjera edhe rrethi i teat-

rit, i cili zhvilloi shumë aktivitete që krijuan një traditë edhe për shumë vite me radhë.

Kështu në vitet '50 në këtë qendër kulturore u shfaqën tri drama për fëmijë të autorit rus Arkadi Gaidar, ku Paulini në një moshë fare të re shpalosi talentin e tij të lindur.

Janë vitet e para pas Çlirimit të cilët ndikuan edhe në gjendjen ekonomike të familjeve shqiptare, ku shpesh edhe në moshë të re, rinia do të ishte pjesëmarrëse në çdo ndërmarje ekonomike. Kështu, që në vitin '52 për këto arsye edhe Paulini në moshën 17 vjeçare filloi punë në një ndërmarje të qytetit të Shkodrës.

Në vitin 1953, falë pasionit dhe vullnetit që e karakterizonte Paulinin, u aktivizua pranë Shtëpisë së Kulturës dhe po në atë kohë nën drejtimin e regjisorit të mirnjohur Andrea Skanjeti, u shfaq e para premierë estrade amatore "Estradë në Penxhere" ku protagonistë ishin Tano Banushi dhe Paulin Preka, të cilët sollën një frymë të re në skenën e teatrit të humorit në qytetin e Shkodrës.

Në vitin 1954, kur sapo ishte kriju "Klubi i Punëtorëve" e ftuan të luante një rol tek drama bullgare "Traktoristat" me regjizore Violeta Sekuj. Me këtë dramë konkuroi në Takimin Zonal të Veriut ku u shpall Laurat i këtij takimi, duke u vlersuar me diplomë nderi për interpretim të lartë artistik.

Në fund të vitit 1954 u mobilizua në shërbimin e detyrueshëm ushtarak ku aktivizohet në Shtëpinë Qendrore të Ushtrisë pranë Estradës së Ushtrisë në role të ndryshme si, konferencier, recitues e pso jo edhe si aktor deri në fund të shërbimit në vitin 1956.

Viti 1957 e në vazhdim ishin mjaft të ngarkuar me aktivitete dhe ai edhe pse punonte marangoz në kooperativën e punim drurit, pasditeve aktivizohej në Shtëpinë e Kulturës nën drejtimin e të mirnjohurit Andrea Skanjeti. Atë vit kjo trupë shfaqti dramën "Rinia e Ballarëve", një dramë që zuri vendin e parë në Lëvizjen Amatore Kombëtare. Në këtë dramë iu besua një rol me peshë mjaft të madhe, të cilin e interpretoi në mënyrë të shkëlqyer.

Trupa teatrore është krijuar që në vitin 1949, por shfaqiet e saja do e gjejnë vehten në kushte komode në kohën kur kjo trupë do të interpretojë në skenën e Teatrit "Migjeni" që deri në ditët tona do të ishte një tempull legjendar i artit dhe i kulturës.

Duhet theksuar se trupa amatore e Shtëpisë së Kulturës, në vitin '57 vë në skenë një komedi brilante që mirëpritet me duartrokkitje në një turne në qytetet

kryesore të vendit, duke u bërë kështu bërthama e trupës së ardhshme profesioniste të teatrit "Migjeni" dhe premisa e teatrit të estradës që nuk do të vononte të jepte shfaqet e para në këtë teatër.

Në vitin 1957 qyteti i Shkodrës ka teatrin e vet, një tempull që do të bënte histori në jetën artistike të qytetit, por

vonë atë edhe në radhën e autorëve humoristë.

Ndër pjesët më brilante të repertorit 40 vjeçar të estradës interpretuar nga Paulin Preka, aktorët e mësipërm, si dhe një brezi më të ri mund të veçojmë: "Fotografi", "Kola i dritave", "Familja-A, familja-B", "Tuçi e Lokja", "Dasme e Refikut", "Mini e Minusha", "Wikend 96-76" etj.

Që nga viti 1967 e deri më sot janë shkruar nga aktori dhe autori Paulin Preka me qindra skeçe, parodi, dialogje e monologje. Materialet e tia janë pëlqyer dhe janë kërkuar e luajtur nga trupat profesioniste të rrethëve të ndryshme si ajo e Peshkopisë, Kukësit, Estradës së Ushtrisë, Durrësit, Beratit, Elbasanit, Pogradecit si dhe nga lëvizja amatore e qëndrave të punës të qytetit të Shkodrës, nga Mirdita, Lezha, Puka etj.

Aftësitë e tia si aktor, por dhe si autor libretesh, deri te gjinitë e vogla të humorit: skeçe, parodi, kuplete, pantonima, monologje e dialogje, grimca humoristike etj., kanë një vazhdimsi deri në këto ditë që po flasim,



edhe në rang republike e më gjërë. Ky tempull do të mblidhte në gjirin e tij djemt dhe vajzat më të talentuar shkodranë, të cilët në atë skenë, në atë sallë dhe para atij publiku artdashës do të bënin shkollën dhe akademinë e tyre. Në këto ambiente, mes gjirit të kësaj trupe u rrit profesionalisht edhe aktori i mirnjohur Paulin Preka, i cili jetën jashtë teatrit e bënte vetëm kur shkonte në shtëpi.

Për rreth 9 vjet që punoi si aktor drame, Paulin Preka interpretoi në disa role kryesore, ndër të cilët mund të veçojmë dramatizimin e romanit "Kënetë", përgatitur dhe vënë në skenë nga regjisorit Esat Oktrova, ku Paulini u shqua në këtë shfaqje.

Regjizori i trupës profesioniste, Lec Shllaku e ftoi të interpretonte tek drama "Shtatë Shaljanët" të të madhit Ndreke Luca në rolin e Abdullahut (birit të vezirit të Shkodrës), dramë që duke u interpretuar nga mjeshtrat aktorë të dramaturgjisë shqipëtare, pati një jetëgjatësi të habitshme.

Sipas studiuesit Isa Alibali, në atë kohë u vu në diskutim: ku do të shquhej në të ardhmen Paulini, në teatër apo estradë dhe Paulinin e gjejmë aktor të estradës së sapo krijuar, që me aftësitë e tij rifreskoi këtë gjini, duke u bërë kështu për vite me radhë një ndër interpretuesit më brilant të skenës. Një vit më vonë për arsye të mungesës së maresialeve letrare, Paulini provoi për herë të parë t'i vijë në ndihmë trupës së estradës duke shkruar skeçin e tij të parë "Bacë Byreku" i cili u luajt nga mjeshtrat Tano Banushi, Zyli Miloti dhe Jolanda Shala dhe që do ta radhiste më

sepse plotësojnë figurën e këtij artisti të kompletuar si interpretues dhe shkrimtar.

Pas viteve 1990 janë një sërë premierash të shkruara si librete të vëna në skenë, si ajo e të shtundeve gazmore në RTSH në vitin 1994, ku spikasin materialet e "Ndihmave humane", "Liçensa", "Dasme e Refikut" e mandej në këto vite materiale që kanë mbetur në kujtesën e spektatorëve si "Krapit", "Kena harru baben", "Urgjenca", "Pikniku 1977 e 1997", materiale në vargje si "Eksodi", hapja e recitalit të Sandër Ruçit "Çka t'tha" e shumë e shumë të tjera, si "Operacioni i dajës", "Udhëtim me mikrobu" etj.

Në vitin 1998-1999 një mori poezish që janë të arkivuara nga familja, të cilat u transmetuan fillimisht në Radio Klan e mandej edhe në Radio Shkodra të tilla si "Një letër mikut tim", "Prostitutës", "Tomasi", "Shkodër loces", "Zotni", "Andërrgrash", "Pensioni" etj.

Paulini i përket dy zhanreve skenike: teatrit të dramës dhe atij të humorit, rreth 9 vite në dramë dhe 37 vite në estradë, karrierë plotësisht e mjaftueshme për të krijuar personalitetin e tij.

Nuk mund të mos mbahen mend nga publiku shkodran interpretimet brilante të Paulinit përkrah gjigandëve të skenës: Tinka Kurti, Roza Xhuxha, Prengë Lëkunda etj. në rolin e Murrashit tek drama "Toka jonë" shkruar nga Kol Jakova, si dhe rolet kryesore tek "Një tragjedi amerikane" shkruar nga Teodor Drajzer, "Familja e peshkatarit" shkruar nga Sulejman Pitarka, "Bileta e lotarisë" shkruar nga Gjergj Vlashi, Niqiforin në komedinë "Shoku

Niqifor" shkruar nga Pëllumb Kulla, si dhe freskinë që solli gjatë pjesëmarrjes në tri operata. Me keqardhje mund të themi që kjo pjesë e karrierës artistike të këtij artisti është mbuluar nga pluhuri i harresës dhe është detyra e studiuesëve të teatrit ta fshijnë këtë pluhur.

Paulin Preka me aftësitë e tij doli jashtë kufizimeve konvencionale, si një talent i lindur ai shkëlqeu edhe si aktor i artit të shtatë. Është nëpunës brilant në zgjidhjen e një situatë komike tek filmi "Çifti i lumtur" një ndër perlat e kinemasë shqiptare të komedisë për të kapërcyer vite më vonë përsëri në këtë zhanër me komeditë filmike "Pak fresk sonte".

Paulini nëpërmjet punës së tij intensive, arriti të meritojë nga publiku duartrokitjet dhe simpatinë, ndërsa nga institucionet shtetërore vlerësime të larta. Në vitin 1974 laurohet me urdhërin "Naim Frashëri i Klasit të III", në vitin 1980 me urdhërin "Naim Frashëri të Klasit të II", në vitin 1988 me titullin e Lartë "Artist i Merituar".

Në vitin 1996 pak muaj përpara se të mbyllte marrëdhëniet e punës me teatrin "Migjeni", në takimin e trupave Profesioniste në Tiranë, u vlerësua si "Aktori më i Mirë i Karrierës", "Krenaria e qytetit" në vitin 2009 dhe "Nderi i Komunës" Bushat në vitin 2012.

Për të ditur diçka më tepër rreth figurës së aktorit të mirënjohur Paulin Preka iu referuam monografisë së "Artistit të Popullit" Tano Banushi ku studiuesi Isa Alibali i kushton një vëmendje të veçantë edhe aktorëve të tjerë pjestarë të trupës profesioniste të qytetit të Shkodrës: "Aktori i mirënjohur Paulin Prenka, e ka filluar punën që në vitin 1958 si aktor i estradës. Në premierën e parë, së bashku me Tanon Banushin, ishin konferencierë të shfaqjes, që luajtën rolin kryesor në suksesin e saj.

Paulin Preka shpejt u bë një partner i denjë për Tano Banushin, mësoi prej tij dhe prej aktorëve të tjerë, shpesh herë duke pasur përparësinë, dhe u harmonizua bukur me gjithë kolektivin e aktorëve, ndikoi fuqishëm në rritjen cilësore të estradës jo vetëm me interpretimet brilante, por edhe me shkrimet humoristike shumë të bukura që kanë firmën e tij. Aftësitë e tij erdhën gjithnjë duke u rritur dhe sot ai shkëlqen me të gjithë elementët si një aktor brilant, shumë i dashur për spektatorët dhe gjithnjë i pëlqyeshëm dhe i freskët".

Do të ishte shumë i mangët shkrimi im sikur të mungonin opinionet dhe vlerësimet e një hirësie të nderuar të dramaturgjisë shqiptare, shkrimtarit dhe dramaturgut prof. Fadil Krajës, i cili tha për Paulinin: "Paulin Preka mbetet një ndër ata aktorët nga më të shquarit që shkruan historinë brilante të Teatrit Profesionist "Migjeni" të Shkodrës. Është një ndër figurat më të spikatura dhe më gjurmëlënëse në historinë e estradës Shqiptare në përgjithësi dhe asaj të Shkodrës në veçanti. Aktori i kompletuar me dhunti të jashtëzakonshme për t'u shquar në të dy planet, në tragjikën dhe komikën, për të luajtur "të mirin" dhe "të keqin" si në dramë, si në komedi, si në filma artistikë të njohur. Aktori me një plastikë për t'u patur zili, me një zë melodioz baritonik që i bëri popullore e të pashlyer në ku-

jtësë shumë kuplete e parodi. Ashtu si Bik Pepa, ai ishte poet kupletist i shquar, por edhe autor parodishë, skeqesh dhe komedishë me një akt që kujtohen edhe sot. Janë aktuale edhe sot dhe kujtohen skeçi në vargje "Harapi", apo komedia brilante parodizmi i dramës së njohur "Toka e jonë" të Kol Jakovës, duke i sjellë personazhet në ditët tona të demokracisë.

Largimi i tij jashtë vendit ka lënë një boshllëk të dukshëm në Teatrin "Migjeni" dhe do dekada vitesh të zëvendësohet. Jam krenar që Paulini interpretoi në shumë pjesë të miat, si "Çështja familjare", "Dopio gjshta" etj. Mbi të gjitha jam krenar që Paulini është ndër miqët e mij më të mirë edhe sot e kësaj dite".

Zyliha Miloti "Mjeshtre e madhe" në një bisedë për Paulinin u shpreh: "Paulin Preka është një partner shumë i denjë dhe i talentuar, qoftë si aktor, si artist, qoftë si njeri i jashtëzakonshëm dhe një shkrimtar i mrekullueshëm i humorit. Pranë këtij partneri jam ndërerë shumë e sigurtë me një vërtetësi të madhe interpretative dhe me një sukses të garantuar nga shfaqja në shfaqje. Tek Paulini kam parë njeriun e sinqertë pa egoizëm si artist dhe shumë i dashur, i komunikueshëm në shoqëri.

Me një aftësi të jashtëzakonshme, i paarritshëm në improvizimin e momenteve të humorit, në shoqëri e tavolinë, që rrallë artistë e kanë.

Më vjen keq për këtë partner i cili më mungon jo vetëm mua por edhe kolegëve të mi, jo vetëm si aktor por edhe si shkrimtar, njeri i cili i mungon shumë skenës shkodrane dhe spektatorit shkodran e shqiptar.

Si kolege e tij prej dekadash i uroj shëndet atij dhe familjes së tij dhe jetë sa më të gjatë në skenë pasi ai është akoma aktiv".

Aktori i humorit, i paarritshmi Besnik Çinari kur i kërkova një opinion për kolegun e tij Paulin Preka, me dashuri dhe respektin më të madh tha: "Paulin Preka është aktori më popullor në kuptimin e interpretimit në estraden profesioniste të Shkodrës. Aktori i vërtetë dhe i besueshëm në të gjitha rolet që ka interpretuar, më i lezetshmi në tavolinë. Humori i Paulinit, i Fadil Hasës dhe pa modesti i imi, ishte më brilant, më antiqeveritari në kohën e Partisë. Pak kush e din se ai ishte në grupin organizator me të ndjerin Pjetër Arbnori, por Pjetri nuk e nxori kurrë si shok dhe kojshi. Unë me Paulinin kam fjetur gjithkund, dimër-verë në hotelet e Shqipërisë dhe kemi fjetë bashkë për të shpëtuar 80 lek të vjetra për të pirë në mëngjes kafe e fërnjet. Ky ishte fukaralëku i asaj kohe.

Pak kush e din se ai ishte aktor i shkëlqyer dramatik, mjafton të përmendi historinë Jarkutase dhe sidomos ka shkëlqyer tek "Kënetat" shkruar nga Fatmir Gjata, ku shkëlqeu në rolin e Stavri Laros. Sot jeton në Itali, i mungon ambientit shkodran, i mungon skenës ku ai dha gjakun dhe djersën e tij. Përveç si aktor ai ka shkruar me dhjetra skeçe, kuplete, parodi dhe

grimca humoristike. Më 2 shkurt mbush 79 vjeç, unë i uroj 100 vite në skenë edhe 10-15 vite të tjera në shtëpi e në reanimacion me të mirë e me të keqen e vet, veç të jetë gjallë".

Mojsi Banushi, djali i "Artistit të Popullit", aktorit të madh të humorit Tano Banushi u ndje shumë i vlerësuar, kur unë kërkova një opinion për veprimtarinë artistike të Paulin Prekës. "Eh, filloi bisedën ai, Paulini ka karakter të veçantë. Unë nuk kam luajtur me të por më shumë kam dëgjuar nga im at'. Paulini i donte rolet me karakter të sinqertë, gati-gati "tuafë", qofshin këta qytetar a fshatar, jo fortë in-



(shoqërore nga Osman Kazmaj)
"Mos qoftë e fundit,oj Loke!"

teligjentë dhe Paulini me humor thoshte: "Me qenë kështu nuk don me thënë me qenë i trashë". Duke i njohur këto karaktere ai vendosi të shkruajë vetë për ta, duke ia hequr "të drejtën" Kolec Pepës e Paulin Selimit.

Vitet e fundit, çdo verë dhe para vitit të ri unë rri me Paulinin, jo më si djali i shokut të vjetër, Tanos, por si miq të mirëkuptueshëm dhe sinqerisht kjo më bën krenar në shumë ambiente të shtrësave të ndryshme të qytetit. Të gjithë e duan, e respektojnë, e ftojnë dhe kjo nuk është pak për një artist si Paulini. E presim të vijë në qershor dhe unë do të kujtohem për ju si autor i shkrimit e bashkë me të, do të pimë diçka me ty në shenjë mirënjohjeje".

Në gjeografinë e vlersimeve dhe opinionëve për aktorin e famshëm Paulin Preka shkuam edhe në qytetin e Durrësit ku morëm një mendim edhe nga aktori i humorit në estraden profesioniste të këtij qyteti z.Muharrem Hoxha i cili me dëshirë e pasion tha: "Paulin Preka është një aktor i dimensioneve të mëdhenj dramatik dhe komik, humoristik dhe i krijimtarisë që rradhë i ka një artist kaq i mrekullueshëm. Plejada e aktorëve të mëdhenj të teatrit "Migjeni" me Tano Banushin në krye treshja e fortë dhe simpatike Tano-Zyli-Paulini, me gjuhën e sportit një treshe sulmi që e kishte zili gjithë Shqipëria. Kjo që po them pasqyrohet më së miri tek skeçi "Fotografi", në gjuhën e kinematografisë tre muskëttjerët. I uroj shëndet me Kristinën, me djemt e me vajzë, me nuse e me dhandërr, nipa e mbesa, t'i ketë shëndosh e t'i lejë mbrapa. E përqafoi prej së largu Muharrem Hoxha".

Rastësisht gjatë një bisede me mikun

tim, mësuesin e nderuar Osman Kazmaj, shkrimtar dhe njohës i mirë sidomos i letërsisë teatrore, duke diskutuar rreth këtij shkrimi, më kërkoi që t'i lija një hap-sirë për të thënë dy fjalë për mikun e tij Paulin Preka. Dhe unë pa dyshim ja krijova me kënaqësi këtë hap-sirë: "Të japësh një opinion për artsitin e madh Paulin Preka si aktor nuk do të ishte e vështirë, pasi për këtë flet karriera e tij rreth pesëdhjetëvjeçare në skenë, por të flasësh për Paulinin si njeri vështirësia fillon në qëmtimin e fjalëve të duhura që do të shërbenin si penelata në skicimin e portretit e tij të mrekullueshëm shpirtëror e fizik, gjë që nuk do të hezitjoja ta bëja sikur të lejonin hapësirat e këtij shkrimi.

Kam pasur fatin ta njoh nga afër që kur isha student në Institutin e Lartë Pedagogjik të Shkodrës, kur Paulini vuri në skenë një premierë estrade me trupën amatore të këtij instituti, shfaqje që falë Paulinit si regjisor dhe libretist u mirëprit jo vetëm në skenat e qytetit, por edhe jashtë tij. Eksperienca që fitova në ata vite studentore do të më shërbente më vonë në punën dhe krijimtarinë time në institucionet kulturore të Shkodrës dhe Pukës.

Puna e tij e palodhshme me talentët e rinj është një nga karakteristikat që dua të evidentoj në këtë opinion: Paulin Preka ka qenë dhe është një mik i të

rinjve, një shok dhe një mësues i vërtetë.

Na mungon shpesh fizikisht, na mungojnë bisedat e tij gazmore, batutat plot kripë, barcoletat kurdoherë të freskëta, por duhet të them se këto na i kompensojnë disi disqet e kasetat si dhe retrospektivat në televizionet lokale e kombëtare.

I uroj nga zemra jetë të gjatë e të lumtur, shëndet e vitalitet duke shpresuar se një ditë do të kemi në dorë një libër me krijimtarinë e tij të mrekullueshme, i cili ta radhisë atë në vendin që i takon jo vetëm si aktor, por edhe si shkrimtar i humorit."

Paulin Preka me familjen e tij prej vitesh jeton në Itali, është shumë i lumtur së bashku me bashkëshorten e tij Kristinën dhe fëmijët, të cilët kanë krijuar familjet dhe të ardhmen e tyre, dhe si trashëgimtarë të familjes Preka bëjnë përpjekje të mbajnë gjallë atë që mund të quhet "Dosja artistike Paulin Preka", Ama, mendoj se kjo dosje faqen e parë dhe faqen e fundit i ka në Shkodër, sepse nuk është çudi që një ditë papritmas të shohësh në Shkodër një person me një ecje krejt të veçantë, që të kujtonë lëvizjet e një aktori në skenë, me përshëndetje gati-gati aktoreske, me një çiltërsi të një portreti të paplakur kurrë. Më pas atë e gjen në ndonjë lokal, në lagje apo qendër, mes miqsh ashtu alegro e me buzë në gaz dhe të duket se e ke parë edhe dje apo pardje, pasi mungesën e tij fizike, "zhdukjen" për disa kohë e kompensojnë respekti dhe afriteti që ka ai vetë me të gjithë shkodranët. Ta dinë mirë se në Shkodër ka ardhur Paulin Preka.

Përgatiti Ramazan Çeka

"Qytetar Nderi i Komunës Qendër-Koplik", miku i jone, Kadri Sadik Ujkaj

Ne këtë ceremoni, Kryetari i Komunës, Isa Rama, ne mes të tjerave theksoi: "Nderimi dhe mirënjohja jone e veçante sa si pushtet lokal, sa si komunitet, shkon kësaj radhe, veçanërisht, në adresë të dy personaliteteve të shquara: Se pari, për Mjeshttrin e Madhe Fadil Kraja, intelektual dhe dramaturg me autoritet të padiskutueshëm në mbarë kombin shqiptar, Laurat i Çmimit të Republikës, Mik i Malësisë së Madhe!

Së dyti, për Mjeshttrin e Madh Ahmet Osja, "Anëtar Nderi i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë dhe Kosovës, Ankona(Itali) dhe Florida të SHBA!

Pse? Sepse, sot na nderojnë dhe privilegjojnë si komunitet dhe si pushtet lokal duke na paraqitur kërkesën dhe propozimin e tyre për dhënien e titullit "Qytetar Nderi", banorit tonë, edukatorit të palodhur ndër breza, shkrimtarit dhe studiuesit, kritikut të mirënjohur letrar, intelektualit, Kadri Ujkaj, "Mirënjohja e Malësisë së Madhe", duke shprehur kështu edhe respektin ndaj pushtetit lokal dhe ndaj ne të gjithëve si komunitet ku u lind, u rrit dhe u afirmua si figurë publike.

Në emër të të gjithë të pranishmëve dhe sidomos të pushtetit lokal, më lejoni t'u shpreh me këtë rast akademikeve të nderuar gjithë respektin dhe mirënjohjen tone për aktin e tyre fisnik, intelektual si investim shembullor në nderimin e njeriut tonë, nderim po aq i pushtetit lokal dhe i vlerave që janë afirmuar gjatë



dekadave në fushën e arsimit, edukimit, letrave shqipe dhe studimeve shkencore në juridiksionin tonë.

Në këtë drejtim roli dhe përkushtimi i zotit Kadri Ujkaj si shkrimtar, studiues dhe intelektual ka merituar gjithnjë vëmendjen e secilit nesh duke i dhënë kështu një përmasë të re njohjeje

civilizimit tonë si komunitet, si vlera që ka qenë dhe vazhdon të jenë subjekte sodisfaksioni të veçantë dhe vlerësimi për komunitetin tonë.

Studimi, me autor Kadri Ujkaj duke iu referuar një dokumentacioni të pasur arkivor si ai mbi shkollën e parë shqipe, shtator 1914, me mësues poliglotin Prekë Gjon nga Bajza, apo dëshmia interesante mbi shkollën e parë të mesme bujqësore të hapur nga Venediku mbi 600 vjeçare në lagjen e Podgorës, ku më interesantja vjen dëshmia mbi strehimin e menaxherit të gardës së Heroit tonë Nacional, Gjergj Kastriotit, Gjergj Mukës në vitin 1452, në lagjen Lohe e poshtme-Drogovojë, si familje e përndjekur nga pushtuesi osman. Funkcionimi i zyrës së parë të pushtetit lokal dhe i shkollës së parë, fill pas Çlirimit të vendit, me qendër në lagjen Mehmetaj, sikur origjina e lagjeve të ndryshme dhe e vet fjalës Koplik, përshkrimi i qasjeve historike nga periudha e kohës së Gjergj Kastriotit, gjate viteve të pavarësisë deri në Luftën e Koplikut, Luftën e Reçit apo edhe gjatë regjimit totalitar e të tjerë, e të tjerë janë studime interesante të Kadri

Ujkajt, që pasurojnë vlerat tona historike, kulturore dhe arsimdashëse si njësi vendore.

Vlera të tilla kaq serioze janë padyshim vetëm si produkt i punës së palodhur prej hulumtuesi, të zotit Kadri Ujkaj, anëtar i Seminarit shkencor ndërnacional "Shkodra në Shekuj", anëtar i Lidhjes së Shkrimtarëve dhe Artistëve të Shqipërisë, kryetar i Lidhjes së Shkrimtarëve dhe Artistëve dhe zëvendës kryetar i Unionit të Gazetarëve Malësi e Madhe, autor dhe bashkautor i dhjetëra librave me hulumtime letrare, publicist dhe eseist, bashkëpunëtor i mediave të shkruara dhe elektronike brenda dhe jashtë vendit deri në SHBA, organizator i intervistave Vip në TV-Shkodra, TV-Rozafa, TV-Kopliku, TV-Boin(Mali i Zi) e të tjera, filluar me personalitete madhore si Fadil Kraja dramaturgu, Fadil Paçrami, Lukë Kaçaj "Nderi i kombit" deri tek gjeniu i letrave shqipe Ditëro Agolli "Nderi i kombit" e të tjerë e të tjerë.

Janë pikërisht këto vlera që kanë motivuar edhe personalitetet e shquara nga qyteti i Shkodrës Profesorët Fadil Kraja dhe Ahmet Osja sikurse edhe angazhimin tonë si pushtet lokal për t'i akorduar sot, në këtë ditë solemniteti mes nesh, titullin më të lartë "Qytetar Nderi i Komunës Qendër-Koplik", djalit tonë dhe mikut të të gjithëve Kadri Ujkaj ...".

Miku i jone, Kadri Ujka e gëzosh këtë vlerësim, këtë titull te larte! Te urojme jete te gjate dhe lumturi!

Korrespondenti i gazetës "DUKAGJINI"

DIVORCI PO NA VRET...

«Më mungon diçka nga lumturia ime, më mungon lumturia e të tjerëve»,

Shën Agustini

Të dashur lexues çdo ditë e më shumë po dëgjojmë se si çiftet po divorcohen. Çdo ditë e më shumë familja, vatra e jetës, vatra e dashurisë po shkatërrohet.

Ju ftoj të ndalemi këtu, lë të mendojmë më shumë, ku po shkojmë me këto veprime tona, ne po largojmë veten nga dashuria e Zotit, me veprimet tona, thashethemet, krahbajtjet, heshtjen, po e lejojmë këtë fenomen shkatërrues të jetës të rritet. Është për tu vajtuar kjo gjendje. Bashkëshortët po e humbin vetëdijen ndaj mëkatit, janë të pa përgjegjshëm në veprimet e tyre e kjo papërgjegjësi po shkakton atë që tani po jetojmë. Divorci përbën një problem madhor të ditëve të sotme. Rëndësia e këtij problemi rritet për shkak të përpjesëtimeve të mëdha që ka marr sot.

Mosha më e prekur nga divorci është mosha 30 vjeç dhe 41-60 vjeç. Vërehet një numër më i madh i çifteve të divorcuar. Çiftet e divorcuara në pjesën më të madhe janë me arsim të mesëm ose të lartë. Divorci, si dukuri në Shqipëri ka qenë historikisht i kushtëzuar nga drejta zakonore. Ajo, ndonëse e pashkruar, ka vepruar për mijëra vjet për rregullimin e marrëdhënieve shoqërore në përgjithësi e të atyre martesore e famil-

jare, në veçanti.

Domosdoshmërinë e shmangies së divorcit nga shoqëria shqiptare përfaqësuesit e klerit katolik e bazojnë në "argumentim" teologjiko-sociale, sipas të cilave "Martesa është e shenjtë, prandaj ç'ka lidhë Zotit, njeriu nuk duhet të guxojë me e zgjidhë". Lidhur me këtë çështje është prononcuar edhe At Gjergj Fishta, i cili shkruante: "Sistemi më i përsosur dhe më ideal i martesës është martesa e krishterë, e bazuar, ndërmyjet të tjerash, në parimin e pazgjidhshmërisë së martesës (mos lejimit të shkurorëzimit) dhe në parimin që kreu i shtëpisë të jetë burri".

Të dashur vëllezër dhe motra ju të gjithë që pa u menduar mirë i thoni njëri-

tjetrit: Kemi gabuar, ne nuk kemi lindur për njëri-tjetrin, nuk mund të jetojmë më kështu. Është më mirë që të ndahemi se do të jetojmë më mirë. Sipas jush keni të drejtë. Ju ftoj të ndaleni pak e të mendoni. Ku po çoni besën që ja dhatë Zotit dhe njëri-tjetrit se, do jetoni së bashku në sëmundje dhe vështirësi. A mos vallë kjo besë e lidhur ishte një ndjenje e çastit apo një vidioklip që duhet bërë. Ju që keni vendosur ti jepni njëri-tjetrit lamtumirën e fundit me përfundimin e procesit gjyqësor, si jeni në këto çaste përballë Zotit? - Besëshkelës. Si do të të ndjeheni ju përballë fëmijëve tuja që ngasin sa tek njëri, tek tjetri, në vend që ai të gëzonte ngrohtësinë e dorës suaj, të gëzonte përkujdesjet tuaja. Ky fëmijë shpesh herë në vende që të mbushet me mësimet për Zotin që e ka krijuar për ta gëzuar dashurinë, në vend që të mësojë për jetën

dhe bukurit e saj, ai fatkeqësisht mbushet me të metat tuaja, që ju, ja ushqeni me qëllim që ai të mbajë krahun e njërit prej jush. Po përballë prindërve tuaj si do të ndiheni ju, ata gjithë jetën e tyre janë thyer brinjësh për t'u edukuar, për t'u rritur. Shikoni mirë fytyrat e tyre, lexoni vuajtjet e tyre që jeta i ka gdhendur. A nuk është sakrilegj për ty i dashur vëlla që në vend që ti thoshe mirëmëngjesi babë, mirëmëngjesi nënë, ata dëgjojnë grindjet që ti bënë me gruan tënde. Ose nëna jote në vend që ti shijoj kafen nga duart e gruas tënde asaj i duhet që të merret me fëmijët tu, për ti përgatitur për në shkollë. Shpirti i saj është i copëtuar, sepse e shikon të ardhmen e djalit të saj të shkatërruar. Ju lutem ndaluni pak dhe mendoni, keni gabuar ndaj njëri-tjetrit. Po të gjithë gabojmë, por kurrë nuk është vonë që të pendohemi dhe të kthehemi prapa se, krahët e të dashurve tanë kanë për të qenë të hapur. Forcën kërkoja Zotit dhe ai do ta dhuroj.

Shpesh herë ne ankohe mi se, jemi të vdekur shpirtërisht, saqë e kemi të vështirë të lutemi dhe Zotit, nuk u përgjigjet nevojave tona. Por nuk është kjo, për shkak të krenarisë sonë ne jemi larguar nga Zoti. Na duket se po na ndjek fati i keq, çdo gjë që ndërmarim nuk përfundon me sukses, sado që të përpiqemi. Kjo ndodh, sepse unë jam bërë Zoti i vetvetes, unë jam i pagabueshëm, unë kam të drejtë, Unë, unë, unë ...

Ndalu gërmo në ndërgjegjen tënde dhe shiko fajet dhe



Në "Rozafa Resort", Profesor Lulash Nikë Palushaj

Midis një entuziazmi që injekton energji pozitive në Dhomen e Madhe të Rozafa Resort, u celebrua libri më i fundit të shqiptaro-amerikanit Lulash Nikë Palushaj, me titull "Nusja me duvak të bardhë". Morën pjesë intelektualë nga Shkodra e Ulqini, Tuzi e Tetova, Lezha e Kurbin. Mitingun e përcolli në rolin e moderatores, aktorja e Teatrit Metroplitan të Veriut Shqiptar "Migjeni", Rajmonda Marku. Fjalën përmbledhëse e mbajti shkrimtari dhe botuesi, me banim në Shkodër, Dashamir Cacaj, në cilësinë edhe të Sekretarit të Klubit të Shkrimtarëve Shkodranë. Së bashku me këtë shpalim të shkurtër, po botojmë të plotë materialin që rreket të absorbojë vlerat dominuese të romanit më të ri të Profesor Palushajt. Si në pak raste pikante, Shkodra tregoi se e ka tagrin të evidentojë vlera universale, për të dëshmuar sono cui për të vitalizuar një adrenalinë që gjallëron shpirtëra e motivon klas e modernitet. Tek qytetarët shkodranë dhe tek qytetërimi klasik i këtyre të fundit.

Ceremonia u zhvillua me datën 1 mars 2014. Fjalën e hapjes e mbajti, Dashamir Cacaj, i cili ne ems te tjerave, u ndal: "... Sa herë kam fatin e rastis me mbajtë një fjalë më të gjatë përpara një auditori të caktuem, kujtohem se publiku që asht mbledhë e të dëgjon ty kur flet, e meriton një falenderim të përzemërt.

Në rastin e ditës së sotme ky falenderim vjen nga përtej brigjeve të Atlantikut. Na e sjell një bashkëkohës e bashkëkombas. Thirret Lulash Palushaj. Dhe asht jo vetëm shkrimtar.

Thonë shtegtarët se tërthorça të nxjerr ma shkurt për atje ku je nisë. Unë do të eci nëpër tërthorçë për mos me u vonue, e mos me e bjerrë as kohën që ju po më jepni. Do t'ju baj me dije se kush asht protagonist i kësaj dasme vërtet të shyretshme.

Ka zbritë nga pjerrinat. Ka pi ujë bjeshket dhe asht rritë bashkë me lisat. Një çift i urtë dhe i bukur në dukë i kanë dhanë hijeshi e vrulle. Jo vetëm me u përballë me diva e demonë. Por, me krijue një short që të buzëqesh në jetë e të mundëson për me dalë në krye të redit para të tjerëve që janë nis me ty nga i njëjti start.

Qysh fëmijë asht dallue ndër shokë. Asht shkollue ndër disa etapa derisa ka fitue me mundim Sizifi e rrapëllimë Titani, gradën e Profesorit në mësuesi e në shkrimtari.

Do t'ju dukesh patetik po t'ju thosha se sa Sizif e sa Gjergjelez asht Lulash Palushaj! Pakush ka mbetë pa e njoftë me rranjë e me degë. Se njeriu me kontribute del në breg e ja kris kangës për me e dëgjue shkrep, lugjet, shqipet, zanat ...


Njëri nga kontributet e mëdha të Profesorit të nderuem asht shkrimi. Shkruan në gazeta e revista. Prezent asht në media e printueme dhe në atë virtuale. Por shkruen edhe libra. Këta të fundit i përgatit me kujdes, i paraqet si mall luksi dhe i bën dhuratë. Një rast që haset rrallë ose nuk ban gjurmë askund.

Biblioteka e Lulash Palushajt numëron disa tituj. Ma në dukë janë dy vëllime me

në Shkodrën metropol, jo djep por shtrat në kuptimin e zagnës që frymon talente. Paraqitet midis jush, e autori i "Nusja me duvak të bardhë" asht kryeultë se don me kenë fisnik në trojet e fisnikërisë shkodrane.

Libri tregon një histori. Atë që njohim jo pak. Të Norës së Kelmendit. Që ka gjithçka të re, të pashkrueme deri në këtë kohë. Ndodhitë vijnë në variantin taze. Dhe këtu qëndron merita e autorit.

Shkrimtari Palushaj paraqitet në këtë ployë si një vëzhgues i hollë. i përpiktë deri në detaje. Si gjahtari që e çon në fluturim dhe e vret dukuninë që stonon e verbon. Bleta nuk ka frikë se ia këpusin krahët lulet e livadheve e rrëpinave.



poezi e me poema. Dy vëllime të trashë janë të llojit memuaristikë. Dhe dy librat më të mbramë janë të gjinisë së romanit. I kësaj gjinie asht dhe libri që po celebrujmë sot. Një gabim teknik e paraqet si Esse, ndërkohë asht roman si plot të tjerë që kanë frymën e kohës sonë.

Librat e Lulash Palushajt janë në Prishtinë e në Shkup. Në Tuz e në Ulqin. Në Tiranë e Shkodër. Janë arkivue ndër biblioteka e librari. Janë paraqitë në Bazë të Malësisë së Madhe. Në Tuz e në Ulqin. Tash i vjen radha të vendoset qershia mbi tortë. Paraqitet libri i mbramë

Libri që po celebrujmë apo ma mirë me thanë po çojmë në altar, nuk zatetet ndër brinjë përsiatjesh. Ndodhitë kanë mish e gjak. Kanë ndodhë, kanë ba bujë, kanë ardhë në ditët tona, anipse me dregëza nëpër shtat.

Përshkrimi i penës së Palushajt, shmang fasadën. Ngjarjet shohin larg pa përdorur asfarë lupe. Ngjitjet e teposhtet janë aty. Kapërthehen ndër vedi e bien në ujdë. Lidhin usulle. Mbeten të prekshme. Delikate ani. Dhe me një patetizëm që vetëm në këtë rast pranohet.

Libri i Palushajt asht parzmore e qën-

dresës. Kujtesa nuk guxon me e harrue. Le të mbetet në arkiv, por mos o Zot se mundet me u lanë në hije. Pa u përmendë. Mos o Zot! Libri asht as hulumtim me profil memuaristikën dhe as roman. Asht të dyja bashkë. Krijon binjakun e vet. Bën ortak ndodhinë tragjike e komike. Ngjiz si zamkë në trinën e ndiesive.

Te proza e shkrimtarit Palushaj, si kërkund, mali ka sy e veshë. Qan e qesh. Asht gardian dhe Spartan! Vetmisë së maleve, filozofon krijuesi, malësorët i pëlqyen dritën dhe ua nëmën hijen.

Kur e lexon dhe kreun e mbramë të librit të Palushajt, të vetëton nëpërmend kumti që i ngjan llavës. Mrekullive në malësi, kurrë nuk ju ndahet oshtima. Malësori asht vetë shkaba. Jeton në majë të shkëmbejve. Fiku e mos mëkato! Flijohu por fluturo!

Lulashi, po i them me thjeshtësi si mik, ka hapë një shkollë të vetën si krijues. E ka thanë me plot gojën: Shkruhet dhe kështu! Se Lulash Palushaj e ka matë pulsin e lexuesit. Ai e kërkon këtë lloj letërsie. Le të thonë nihilistët e smirëzëzët: Asht arkaike. Lulashi thotë: Asht mistike, fisnike dhe heroike. Ani pse asht folklorike!

Mjetet artistike janë me masë. Por janë gjithë hire. Bajnë naze por kanë sharm. Unë do të ndalem në tre kumte, anipse këto janë disa. Urtia me trimni baras jetojnë/ Bukën e mishin në sofër me zemër e shtrojnë! Shprehet Lulash Palushaj. Lëvizja e padukshme e belit asht si njalla në qetësinë e ujit të Cemët. Metafora pozon hijshëm në narrativën maratonë të Palushajt. Malësorët ma afër kanë arkemortin në shpat se kraholin në shtat! Kaq hollë mjete stilistike kam hasë vetëm te Camaj, Koliqi, Pashko Vasa, Anton Pashku, Kim Mehmeti, Nail Draga, Luigj Martini, Ndoc Nikaj, Daniel Gjeçaj, Gjovalin Gjeloshi, Nikoll Vilajeti, Gjokë Luli, Nikë Bunjaj, Pjetër Vukaj e pak të tjerë.

Pa u zgjatë, them megjithë shpirt se më krijuat gjendje për tu shprehur me penelata që kanë hije të randë për atdhetarin e patriotin, mecenatin e shkrimtarin, mikun dhe dainë, bashkëshortin e prindin. Të përmbledhur tek një emën: Lulash Palushaj!

Nuk fola për strukturën e romanit. Kjo ndodh për dy arsye. Dëshiroj me lanë ujë në jaz për me blue mullinj të tjerë. Dhe për me e respektue deri në nderim lexuesin. Laknori duket i shijshëm kur ia heq petat me duart e tua!"

Profesor Lulash Palushaj, te urojme jete te gjate dhe na bashkosh perseri e perseri!

Redaksia "DUKAGJINI"

dobësitë tua, vlerëso vetën dhe tjetrin. Përfundimi është se keni gabuar të dy. Kthehu të lutem, kërkë që të bisedoni dhe thirreni Zotin të ju drejtoj. Pajtohuni, dashuria nuk vdes kur, ajo gjithmonë ka force të zgjohet dhe lulëzoj. Rikthimi i dashurisë të thotë:

1- Të duash burrin me të metat e tij, me sëmundjen, papunësinë, alkoolin, lojërat e fatit, historitë e dashurisë se tij.

- Të duash gruan me të metat e saj, nganjëherë të padurueshme.

- Të duash fëmijën e parakohshëm,

handikapit, ta duash dhe ta pranosh edhe atë herë kur ai (fëmijë) të turpëron.

- Të duash nënën dhe babain e moshuar, të paralizuar, të verbër të tij.

2- Ti kujton se ke falur kur i shtyrë nga një arsye fal? Ti kujton se fal kur pret që dikush të gjuhëzohet që ta falesh.

3- Mos u habitni. Vërtet kërkujmë që Zoti të na falë. Por shpesh në jetën tonë na kërkohet që edhe ne ta falim Zotin.

4- Askënd në botë nuk duam më shumë se të afërmit tanë. Por a e keni vënë re, se asnjëri në botë si hidhërohemi më shumë

se atij që e duam më së shumti, në qofte se ai na lëndon. Pse, nuk e prisje që ai të të lëndonte? Ai e dinë shumë mirë se sa e dua dhe nuk ka të drejt të më lëndoj deri në këtë pikë. Këtë nuk e prisja. Dhe çfarë ndodhë? Përpara asnjërit nuk ngurrojmë më shumë që të falim.

5- Shpesh herë në jetë ne përballemi me veten. Kjo përballje është mjaft e vështirë. Jemi të tradhtuar nga vetja. Nuk e kisha besuar kurrë që do ta bëja këtë gabim. Ku isha, si është e mundur? Të zhytur në këto mendime nuk arrimë të

mendojmë se jemi njerëz dhe nuk jemi të përsosur. Jeta sjell me vete kryqet, të cilat ne si pranojmë si të tilla. Dhe duke mos i pranuar i dyfishojmë ato. Kemi bërë një gabim nuk ia falim vetes, duke mos e gjetur këtë falje ne mbështillemi në mjegullën e fajit që nuk lejon që të shohim atje ku duhet, drejt Dashurisë.

Të dashur lexues po e përfundoj këtë shkrim duke ju ftuar të gjithëve të mendojmë: -Çfarë po bëj unë përballë këtij fenomeni?.....

Roza Pjetri

BREGU I BUBZËZ

NË KËTË BREG TË LUM HUMBET NJOHUNIA E KOHËS EDHE NJI FATBARDHËSI E PALUJESHME PUSHTON GURIN, BIMËN, NJERIN.



Nga ERNEST KOLIQI

(Marrë nga "Gazeta Shqiptare" nr. 275, 1938)

Kjo bjeshkë e Thethit, e quajtur Bregu i Bubzës, që dikur krejt e pyllzue. Gjergji m'a shpjegoi arsyen e emnit që mban. Kaq' e shumë shtazë t'ëgra gjeishin strehë në të saqi nanat për t'i trembun kalamajt kur nuk rritshin të qetë u thoshin: Pusho se po të çoj në Breg të Madh tu Buba!

Nevoja e kullotës për bakti shtyni Thethjanët me i a v zjarrmin pyjeve. Kalzojnë pleqt se nder ato net të perflakuna, nisa digjeshin landët qindvjeçare, ndëejoheshin ulurima e bulurima e arrima, shkerbësh me të hy menera. Tashti aty ku nuk depërtonte kurr syni i drites edhe ujçit dhe harushat kishin strofujt e vet, shtrihet vargu ma i bukur livadhesh që muja të shof mje ne ditë të sodit.

Si kujtim i pyjeve të dikurshme ngrihen aty këtu mbi shtroje të barosuna disa shtriqe lisash të thate e të zbardhuem,

tepricë e mallëngjyeshme e një populli bimuer që pat dikur një jetë të stërfuqishme.

Ky breg i lum del në trajtën e një trikan-dëshi vigan prej rranxave të Majes s'Alisë e të maleve që rrijnë paranesh Qafa e Valbonës edhe qet pingul majucin mbi lug të Thethit. Majuci i trikan-dëshit pezull mbi një humnerë njimij metrah thirreth Thepi i Kryjes edhe peruan një balkue natyror prej kah soditë syni lagjet e ndryshme të Thethit me të gjitha malet për rreth edhe një pjesë të Lugut të Shales. Ka plot kso tarracash ajrore ndër male t'ona, por prej kësaj hapet pamja ma e mrekulueshme e Verit të Shqipnis.

Dal me Gjergj Pllumbin neper livadhe. Jane oret e para të mëngjesit. Nji diell i lehte, nji diell i ri leshon rreze të gjalla e të paluajshme që nuk t'i vrasin aspak syt. Duket si të donte dielli me i a damun këtij breg hisen e dritës së vet ma të kulluet. Ajo hise drite ulet si nji dhuratë e zgjedhun, si nji lemim dashunuer mbi bar të përtrim prej shiut që ra nder dit tjera.

Zhegu i forte, vapa e padame e ka pase kuqun bjeshkën an' e kand (me tregon Gjergji) edhe gjaja e gjallë po sharronte pa kullotë. Fatlumnisht muer reja për së mbari majave edhe derdhi hir e jetë para një jave mbi malsit e shkrueme.

Njohet në të marrun fryme pastërtia e ajrit. Në ket ajr të levizun nga furfullit e kreshtave dikon Maja e Alis amen e shëndetshme të halave të veta. Prandaj pak ore gjume mjaftojnë ketu me i a hjeke trupit të laodhunit e udhëtimeve të gjata e të veshitura. Ky ajr i holle, nxitjes i gjakut, fuqizon gjymtyret. Sa me udobit ne kete mengjes ngjitem e dirgjem livadheve! Sa shkathtas jane tue me punue kambe e kercike!

Livadhet gjithenji në vijim njani mbas tjetrit ketu marrin disi ne perpjetje t'ambel, atje butësisht ne teposhte; ketej

rrumbullakohen e trajtojnë logje të nalta me nga nje lis shatorr ne maje, andej rrafshohen në rudina të planta e sosen tu praku i breishtave që ngjiten deri tu Qafa e Valbonës.

Blerimi i Bregut të Bubzës ndrron gjyrë ore e ças si nji shtroje e endun me mendafsh të lilyverte. Pin dritën e diellit me të dridhuna ambelsije.



Gjergj Pllumbi, me të shoqen dhe dy fëmijet e tyre, në vitin 1938

Vrumuliset ky breg i ndritshem si ne valet e nijj symfonije gjelbërre që shkon tue u përhapun deri në shqim të greminave mbi lugje e hije, deri në zemër të pyjeve ku këndojnë zogj të paemen, deri të thepa të kreshtave, ku dhit e egra kacavaren me bria per shkam.

Humbet njohuria e kohes dh'e vendit. Jé ne nji nder të para mëngjese të botes? Kjo natyrë asht virgjrin si n'at kohe. Jé midis t'Europës apo nen do qiej të largët ku flora ngjyre ma të pasuna, ku lule të panoftuna kane erna ma të holla e depertuese?

Nji fatbardhësi e paluetshme pushton gurin, bimën, njerin. Të duket se je kah e ndien barin që rritet ne puthje të diellit, zemren e gurit që rreh plot sekrete shekullore.

E nuk çuditesh ma për kurrjë, mbasi shef atje ne fund të livadheve, ku mularet e sanes leshojnë hije të kalthere, gra që enden rreth stanit me xhubleta sh-

true me spik e me ari, me breza argjenti nji pllambë e gjysmë të naltë me marxhane e pare në qafë e ne veshë, mbasi shef burra në tirq e në mitana tue levizun te kadalshem e tue krye veprat ma të pervujta të bulkut e të bariut me sjellje madheshtore, me nji të prum plot fisniki krenare thyese janë tubë mbretesh të merguem që presin te kethejne ne frontet e humbuna.

Nji gja vetem vijon te çudisi; se si ti, aq i ndryshem prej asaj njerëzie, flet te njajten gjuhë si ata.



VEPRIMTARE DHE GRUPI ARTISTIK I SHTEPISE SE KULTURES BGREGLUMI - SHALE 1972

REDAKSIA

Kryeredaktor: Lazër Kodra
Redaktorë: Lazër Stani, Roza Pjetri, Prelë Milani, Luigj Shyti, Suela Ndoja, Zef Nika, Zef Gjeta, Lulash Brigja